



MISIONI I USAID-IT NË KOSOVË

PLANI STRATEGJIK 2004-2008



KORRIK 2003

ZYRA E SH.B. PRISHTINË

Zyra e Shefit të Misionit

Dragodan, N. Hikmet 30

Prishtinë, Kosovë

1 korrik 2003

Dr. Kent R. Hill

Ndihmës Administrator

Zyra për Evropë dhe Evropë

Agjencia e SHBA-së për Zhvillimin Ndërkombëtar

I nderuari Dr. Hill:

Jam shumë i kënaqur të mbështes Planin e ri Strategjik pesëvjeçar të USAID-it për Kosovën. Programi i USAID-it vazhdon të sigurojë asistencë shumë të rëndësishme për Kosovën, meqë ajo po zhvillon përforsuesit e një demokracie të orientuar kah tregu. Katër vjet pas konfliktit çfilitës, Kosova ende ka nevojë për ndihmën e konsiderueshme të donatorëve. Përceptimi i kësaj ndihme nga homologët tanë kosovarë ka qenë një element i rëndësishëm i suksesit tonë të tashëm dhe padyshim do të kontribuojë në mënyrë substanciale për thellimin dhe qëndrueshmërinë e arritjeve tona në të ardhmen.

Strategjia e prezantuar në këtë dokument mbështet fushat me interes jetik për Qeverinë e Shteteve të Bashkuara. Mbështetja për një ekonomi të fortë dhe demokraci të përgjegjshme është me rëndësi shumë të madhe për stabilitetin e Kosovës, si dhe për aftësinë e saj për t'u bërë pjesë integrale e Evropës. Posaçërisht jam i kënaqur që kjo strategji përfshin çështjet e gjëra të parandalimit të konfliktit dhe të pajtimit, të rinisë dhe të arsimit. Këto janë tema të rëndësishme për rimbëkëmbjen afatgjatë të Kosovës. Përveç kësaj, vënia e theksit në aftësimin e kuadrove dhe në kosovarizim do të sigurojë që programet tona të përqendrohen si duhet mbi atë që lëmë prapa, si dhe në atë si të arrijmë deri atje.

Realiteti i resurseve të pakëta të asistencës së huaj nënkuptonte që ne duhet të bënim disa zgjidhje të vështira në përzgjedhjen e fushave për të ndihmuar. Për shembull, shikoni se çfarë do të mund të bënim me mjete plotësuese për çështjen e ngutshme të kthimit. Me përfshirjen e një spektri të gjerë të këshilltarëve ndërkombëtarë dhe të ekspertëve vendorë në zhvillimin e kësaj strategjie, ne kemi shtuar koordinimin dhe bashkëpunimin me donatorët dhe homologët, duke siguruar që programet e përzgjedhura të kenë prioritet strategjik dhe të përshtaten në kuadër të programeve të gjithmbarshme të ndihmës në Kosovë. Fuqimisht i mbështes programet e paraqitura në këtë strategji dhe kam besim se zbatimi i sukseshëm i tyre do t'ia sigurojë Kosovës themelet e një ekonomie të tregut dhe të një demokracie që ajo aq shumë i meriton.

Sinqerisht,

Reno L. Harnish, III

Shef i Misionit

[Nënshkrimi]

PASQYRA E LËNDËS

PJESA I: Përmbledhje e rrethanave racionale dhe të përgjithshme për ndihmë.....	1
A. Pasqyrë e shkurtër	1
B. Interesat e politikës së jashtme të SHBA-së.....	3
C. Ndihma e USAID-it deri sot.....	4
D. Vështrim i shkurtër i kontekstit strategjik.....	6
1. Ekonomia.....	6
2. Demokracia dhe qeverisja.....	8
E. Faktorët e tërthortë që ndikojnë në strategji.....	10
1. Konflikti	10
<i>Kthimi dhe riintegrimi.....</i>	11
2. Korrupsioni	13
3. Rinia	14
4. Gjinia	15
5. Zhvillimi i aftësisë njerëzore.....	16
F. Prioritetet strategjike dhe drejtimet e programeve.....	16
1. Qëllimi	16
2. Përqendrimi.....	17
<i>Zhvillimi ekonomik:</i>	17
<i>Demokracia dhe qeverisja.....</i>	18
<i>Objektivat e veçantë.....</i>	19
<i>Objektivi i mbështetjes së programit</i>	19
3. Rrugët që nuk merren.....	19
4. Supozimet kryesore për sukses	20
5. Qëndrueshmëria	21
<i>Shkallëzimi.....</i>	21
6. Partnerët e zhvillimit	21
 PJESA II: Objektivat e strategjisë dhe planet e programeve.....	 23
Objektivi i strategjisë 1.2: Klimë e përmirësuar politike dhe institucionale.....	23
për investime në prodhim	
A. Deklarata për objektivin e strategjisë.....	23
B. Analiza e problemeve.....	23
C. Korniza e rezultateve.....	24
1. Lidhjet shkakore.....	24
2. Supozimet e rëndësishme.....	25
D. Përparimi deri tani.....	25
E. Qasjet në program	26
1. Aktivitetet ilustruese.....	26
2. Lidhjet	27
F. Qëndrueshmëria.....	27
 Objektivi strategjik 1.3: Rritja e përshpejtuar e sektorit privat.....	 29
A. Deklarata e objektivit strategjik.....	29
B. Analiza e problemit	29

C. Korniza e rezultateve	30
1. Lidhjet shkakore.....	30
2. Supozimet e rëndësishme.....	31
D. Përparimi deri tanni.....	31
E. Qasjet në program	32
1. Aktivitetet ilustrative	32
2. Lidhjet.....	33
F. Qëndrueshmëria.....	33
 Objektivi strategjik 2.1: Shoqëria civile dhe qeveria kanë partnerë më efikasë.....	34
për të arritur qeverisje të mirë	
A. Deklarata e objektivit strategjik.....	34
B. Analiza e problemit.....	34
C. Korniza e rezultateve.....	35
1. Lidhjet shkakore.....	35
2. Supozime të rëndësishme.....	36
D. Përparimi deri tani.....	36
E. Qasjet në program.....	37
1. Aktivitetet ilustruese.....	37
2. Lidhjet.....	38
F. Qëndrueshmëria.....	38
 Objektivi strategjik 2.2: Qeveri më e hapur dhe përgjegjëse që vepron në përputhje.....	40
me sundimin e ligjit	
A. Deklarata e objektivit strategjik	40
B. Analiza e problemit	40
C. Korniza e rezultateve.....	41
1. Lidhjet shkakore.....	42
2. Supozimet e rëndësishme.....	42
D. Përparimi deri tani.....	42
E. Qasja në program.....	43
1. Aktivitetet ilustruese.....	43
2. Lidhjet.....	44
F. Qëndrueshmëria.....	44
 Objektivat e posaçëm.....	46
OPsç 4.11 Kundër trafikimit.....	46
Opsç 4.12 Energjia.....	47
 Objektivi i përkrahjes së programit.....	50
SO 4.2 Programet e tërthorta.....	50

SHTOJCAT

Metodologjia e zhvillimit strategjik

Tabelat e ndihmave

- 4.1 Ndihma e donatorëve dhënë Kosovës
- 4.2 Aktivitetet e USAID-it për zgjidhjen e korrupsionit
- 4.3 Aktivitetet e USAID-it për zbutjen e konfliktit

Përmbledhjet e vlerësimeve

- 5.1 Përmbledhje e vlerësimit të qeverisë lokale
- 5.2 Përmbledhje e vlerësimit të tregut të punës
- 5.3 Përmbledhje e vlerësimit të korrupsionit
- 5.4 Përmbledhje e vlerësimit të kthimit dhe të pajtimit
- 5.5 Përmbledhje e hulumtimit të rinisë
- 5.6 Përmbledhje e vlerësimit të biodiversitetit

AKRONIMET

AZhN/W	Agjencia e Zhvillimit Ndërkombëtar/Uashington
AAK	Aleanca e Agrobiznesit Kosovar
BPK	Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
AQF	Autoriteti Qendror Fiskal
CIVPOL	Policia Civile
UE	Unioni Evropian
SVH	Sistemi i vërejtjes së hershme
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
PPV	Prodhimi i përgjithshëm i vendit
INF	Institucioni Ndërkombëtar i Financave
PZhBV	Personat e zhvendosur brenda vendit
IDRA	Asociacioni Ndërkombëtar për Mëkëmbjen e Fatkeqësive
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
RN	Rezultati i ndërmjemë
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Forcat e Kosovës
AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
KKZ	Komisioni Komunal i Zgjedhjeve
MFE	Ministria e Financave dhe e Ekonomisë
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
OJQ	Organizatë joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
ZNF	Zyra e Ndhmës në Fatkeqësi
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
NP	Ndërmarrje publike
ShKVRK	Shoqata e Kontabilistëve të Vërtetuar dhe e Revizorëve të Kosovës
MDEJ	Mbështetja për Demokracinë e Evropës Juglindore
NVM	Ndërmarrje e vogël dhe/ose e madhe
OS	Objektivi strategjik
NSh	Ndërmarrje shoqërore
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
START	Ndihma strategjike teknike për rezultatet gjatë trajnimit
UNSCR	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNIFEM	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Grave
KB	Kombet e Bashkuara
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar
QShB	Qeveria e Shteteve të Bashkuara

NJË PROFIL I KOSOVËS



Gjeografia

Sipërfaqja tokësore: 10,908 km² (më e vogël se New Jersey (Nju Xhërsi))

Terreni: Rrafshira të ulëta nëpër Kosovën qendrore, e rrethuar me male nga veriu, perëndimi dhe jugperëndimi.
Lartësia më e madhe: Gjeravica 2,856 m.

Shfrytëzimi i tokës: 52% bujqësi, 39.1% pyje

Kryeqyteti: Prishtina - pop. 400,000

Përshkrimi i popullatës

Popullata: rreth 1.8 milionë. 42% urbane / 58% rurale.

Popullata në diasporë: 400,000 – 700,000 njerëz që jetojnë jashtë vendit. Para të dërguara – vlerësohen në 500 milionë dollarë në vit.

Religjioni: Mbizotëron feja myslimane. Ka edhe ortodoksë dhe katolikë

Etniciteti: shqiptarë kosovarë 90%, serbë kosovarë 8%, të tjerë 2%

Gjuhët: shqipja, anglishtja dhe serbishtja

Qeveria

Misioni i Kombeve të Bashkuara në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës (UMMIK-u, i vendosur më 1999)
PSSP: Harri Holkeri

Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ, vend. 2002)
Shtylla I: Policia dhe Drejtësia
Shtylla II: Administrata Civile
Shtylla III: Demokratizimi dhe Ndërtimi i Institucioneve
Shtylla IV: Rindërtimi dhe Zhvillimi Ekonomik
President: Dr. Ibrahim Rugova
Kryeministër: Bajram Rexhepi
Kryetar i Kuvendit: Nexhat Daci
Qeveria lokale përfaqësohet nga 30 komuna

Përshkrimi ekonomik

Valuta: EURO (nga 1 janar 2002)

PPV në vitin 2002: €1,990 milionë
Për krye të banorit: €1,051

Punësimi:
Ndërmarrjet private 23%
Bujqësia 15%
Punësimi në diasporë 24%

Varfëria e skajshme 12%

**PJESA I: PËRMBLEDHJE E ARSYESHMËRISË DHE RETHANAVE TË
PËRGJITHSHME PËR NDIHMË**

A. PASQYRË E SHKURTËR

Ka 13 vjet nga suspendimi i autonomisë së Kosovës nga Jugosllavia, prej nga filloi rrëshqitja e gjatë në konfliktin etnik dhe shkatërrimi i strukturës së ekonomisë dhe shoqërisë. Kanë kaluar 4 vjet qysh nga se lufta bëri lëmë nëpër Kosovë, duke zhvendosur mbi gjysmën e popullatës dhe duke shkatërruar ekonominë. Rindërtimi i një hapësire funksionale ekonomike, politike dhe kulturore është në rrugë e sipër. Duke përfituar nga çlirimi i kësaj treve nga NATO-ja dhe dhënia i ndihmës humanitare dhe përmirësuese nga kombet nga e gjithë bota, kosovarët janë angazhuar për rindërtimin e institucioneve dhe të themeleve të shoqërisë së tyre. Shtetet e Bashkuara kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë kontribues i madh në këtë përmirësim.

Rindërtimi i Kosovës ka filluar nën patronazhin e Kombeve të Bashkuara (KB). Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të KB-së (RKSKB) e qershorit të vitit 1999 i ka caktuar Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) një mandat të gjerë për ta nxjerrë Kosovën nga kriza dhe për ta shpjerë drejt një subjekti funksional dhe stabil. Atyre u është bashkuar KFOR-i i udhëhequr nga NATO-ja, një forcë shumëkombëshe e ngarkuar për të siguruar sigurinë. Prioritetet më të larta në fund të luftës kanë qenë sigurimi i ndihmës emergjente dhe vendosja e një ambienti të sigurt. E udhëhequr nga UNHCR-i nën shtyllën e UNMIK-ut për çështje humanitare, bashkësia ndërkombëtare ka reaguar shpejt dhe e ka stabilizuar krizën e rëndë humanitare. Ndonëse është larg asaj që të jetë ideale, gjendja e sigurisë është përmirësuar mjaft sa që anëtarët e KFOR-it janë pakësuar dhe shumë përgjegjësi për rendin publik kanë kaluar te forcat e Policisë Civile të UNMIK-ut (CIVPOL) që punon së bashku me Shërbimin Policor të Kosovës..

Duke i zgjidhur nevojat më imediate të paraqitura menjëherë pas mbarimit të luftës, përqendrimi ka kaluar nga parandalimi i përhapjes së armiqësisë të ndërtimi i elementeve të demokracisë, institucioneve për të udhëhequr një qeveri dhe të bazave për një ekonomi të shëndoshë. Duke punuar përmes katër shtyllave kryesore të UNMIK-ut¹, bashkësia ndërkombëtare ka zhvilluar partneritet me udhëheqësit kosovarë për ta nxjerrë Kosovën nga një dekadë e mospërfilljes dhe nga një periudhë e konfliktit të armatosur. Ndonëse ende ka shumë punë për t'u bërë, është bërë një përparim i dukshëm në të gjitha frontet edhe pse jo i barabartë.

Në frontin politik, Kosova ka bërë përparim kyç drejt vetëqeverisjes. Është arritur një ngjarje me rëndësi të madhe në maj të vitit 2001, me miratimin e Kornizës Kushtetuese, me të cilën janë themeluar Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) që

¹ Kriza humanitare është deklaruar zyrtarisht e vënë nën kontroll dhe shtylla për çështjet humanitare është mbyllur në qershor të vitit 2000. Katër shtyllat aktuale, secila e udhëhequr nga një organizatë ndërkombëtare, janë: I – Policia dhe Drejtësia (KB), II – Administrata Civile (KB); III – Demokratizimi dhe Ndërtimi i Institucioneve (OSBE); dhe IV – Rindërtimi dhe Zhvillimi Ekonomik (UE).

përfshijnë Presidencën, Kuvendin dhe Qeverinë. Deri tani tri zgjedhje (komunale në vitet 2000 dhe 2002 dhe ato qendrore në vitin 2001) janë cilësuar si të lira dhe të drejta nga vëzhguesit vendorë dhe ndërkombëtarë. Ndonëse shumë kompetenca ende kanë mbetur nën UNMIK-un, transferimi i kompetencave të IPVQ-ja është në rrugë të sipër. (shih shtojcën 3)

Ky tranzicion nuk vjen pa fërkime dhe debate. Bashkëjetesa e UNMIK-ut me IPVQ-në është herëpashere e brishtë, nganjëherë e përcaktuar dobët, dhe herave të tjera me dyshime. Disa kompetenca i ka mbajtur UNMIK-u, të cilat nga pikëpamja e shumë vëzhguesve, me ligj duhet t'i dorëzohen IPVQ-së. Një pikëpamje e spikatur në mesin e ekspertëve të Ballkanit është se UNMIK-u është duke shkuar me hapa më të ngadalshëm se ata optimalë gjatë dorëzimit të kompetencave të IPVQ-ja. Këtë e kundërshton pikëpamja se në disa fusha, siç është qeverisja komunale, autorizimet po transferohen shumë shpejt, gjë e cila ka mundësinë të shpjerë në rastin më të mirë në mungesë të efikasitetit dhe në rastin më të keq në korrupsion dhe dështim. Ajo që është e sigurt është se rregullat për ushtrimin e disa prej kompetencave të transferuara janë të paqarta duke u bërë burim i mos pajtimeve dhe mos marrëveshjeve. Rezultati i kësaj është se marrja e vendimeve është e ngadalshme dhe e pasigurt. Është vështirë që ndonjëherë të arrihet unanimitet për prioritetet ose hapin e tranzicionit. Megjithatë, ajo që shihet qartë është se nevojitet një sistem më transparent, i përgjegjshëm dhe efikas, i cili do të përcaktonte tranzicionin dhe do t'i sqaronte dhe do t'u jepte kuptim kompetencave të transferuara.

Një çështje kyçe politike me të cilën sot ballafaqohet Kosova është ajo e statusit të saj përfundimtar. Tani Kosova është një hapësirë më së miri e definuar si protektorat i KB-së dhe e administruar nga PSSP-ja. RKSKB 1244 kërkon “autonomi substanciale dhe vetëqeverisëse”, por ka mungesa në përcaktimin se çfarë forme do të merrte ajo. Opcionet sillen prej riintegritimit me Serbinë deri në pavarësi. Ndonëse shumica e bashkësisë ndërkombëtare është përpjekur t'i shmangët ose të shtyrë për më vonë çështjen e statusit përfundimtar (për disa arsye shumë të mira), mbajtja pezull e marrjes së vendimit po ashtu bart me vete rreziqe ekonomike dhe shoqërore. Dykuptimësia e statusit përfundimtar të Kosovës është mjeti kryesor i frikësimit për tregti dhe investime. Më tutje, pengon institucionet financiare ndërkombëtare, siç janë Banka Botërore dhe FMN, për t'i dhënë hua Kosovës, duke e penguar mundësinë e saj për të financuar përmirësimet e nevojshme kapitale. Përderisa diskutimet për statusin final do të mund të shkallëzonin tensionet midis dy grupeve etnike kryesore, injorimi i kësaj çështjeje nuk është as real dhe as nuk shpie drejt pajtimit. Për më tepër, përpjekjet e vazhdueshme nga Beogradi për të vendosur autoritetin e vet në kundërshtim me Rezolutën 1244 janë kundërproduktive për përpjekjet e pajtimit. Shumica e serbëve kosovarë ende shikojnë nga Beogradi për të ardhmen e tyre. Beogradi vazhdon të përkrahë strukturat paralele të serbëve të Kosovës, përfshirë arsimin, shëndetësinë dhe policinë. Ndonëse nuk ka dyshim se strukturat paralele janë një burim i rëndësishëm i të hyrave dhe të punësimit të bashkësive serbe në Kosovë, ekzistimi i tyre pengon përpjekjet për t'u dhënë ndihmën kosovare edhe këtyre bashkësive dhe u jep një nxitje financiare serbëve brenda Kosovës për të mbështetur ndikimin e institucioneve të Beogradit.

PSSP-ja vitin e kaluar, si hyrje në bisedimet për statusin përfundimtar, paraqiti konceptin e “standardeve para statusit” – një përpjekje për të përcaktuar, përmes vendosjes së standardeve, nivele ose shkallë të pranueshme ndërkombëtare të kryerjes së detyrave dhe të ngritjes së kuadrove institucionale para se të hapet çështja e bisedimeve për statusin.² Fatkeqësisht, kjo qasje vuan nga disa të meta serioze. Standardeve u mungon definicioni i qartë, si nga aspekti se çka duhet të arrihet poashtu edhe nga ai se kush është përgjegjës për to. Pos kësaj, standardet janë përpiluar nga UNMIK-u pa asnjë kontribut të drejtpërdrejtë nga IPVQ-ja apo shoqëria kosovare në proces ose përmbajtje, gjë që ka pasuar me mungesë të autorësisë për arritjen e tyre. Prandaj kjo qasje deri tani ka pasur sukses vetëm për të krijuar kundërthënie edhe më të mëdha meqë standardet janë përdorur më tepër si kërcënime sesa si udhëzime. UNMIK-u duket se i ka parë këto të meta në qasjen e tij dhe aktualisht janë duke u bërë përpjekje për t’i korrigjuar këto mospërputhshmëri. Pritet që procesi i rishikuar do të japë disa hapa të qartë dhe logjikë, të cilët Kosova mund t’i ndjekë në rrugën drejt autonomisë kuptimplote.

Bashkësia ndërkombëtare mbase e ka vetëm një mundësi që në Kosovë t’i vërë gjërat ashtu si duhet – dhe kjo mundësi është e pasur me potenciale për sukses. Kosova është një vend ku ekziston një grup i kushteve të favorshme që nuk mund të gjenden në shumicën e vendeve. Strukturat e vjetra në sektorët publikë dhe privatë janë mënjeluar bukur shumë dhe bashkëbiseduesit tanë kosovarë janë shumë të gatshëm për përpjekjet për ndihmë. Ka një gjasë unike për të “ndërtuar rishtas” një qeveri, demokraci dhe ekonomi të tregut që mund të shërbejnë si shembuj në rajonin problematik e edhe përtej tij. Institucionet, ndonëse në fillimin e tyre, janë pastruar nga mbeturinat e të së kaluarës komuniste. Institucionet qeveritare, ndonëse të punësuarit paguhen në nivel dhe nuk janë të kualifikuar sa duhet, nuk janë kapërdisur ende dhe në të shumtën nuk tregojnë shenja të sjelljes grabitqare. Por kjo mundësi ka çmimin e vet. Kërkon që ne – SHBA-ja, UE-ja dhe donatorët e tjerë – të qëndrojmë në rrjedhë dhe të sigurojmë burime të mjaftueshme dhe kohë adekuate për të kryer punën. Mund të ketë ose të paraqiten emergjenca të tjera, por ato nuk duhet të na shmangin nga ajo që mund të jetë mundësia jonë më e mirë për të ndihmuar që në Ballkan të krijohet një demokraci stabile dhe ekonomi funksionale brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Statusi përfundimtar i Kosovës mbetet i paqartë, por pa marrë parasysh atë rezultat të mëvonshëm, ajo duhet të përgatitet për të qeverisur dhe funksionuar me çfarëdo autonomie që në fund do të fitojë.

B. INTERESAT E POLITIKËS SË JASHTME TË SHBA-SË

Stabiliteti në Ballkan ka një rëndësi shumë të madhe si për Shtetet e Bashkuara të Amerikës ashtu edhe për Evropën. Bota ka parë shumë shpesh rezultatet e jostabilitetit në këtë rajon. Ka raporte të ngushta ndërmjet tyre në të gjitha pjesët e rajonit dhe përçarja e njëjës mund të ndikojë në të tjerat. Kosova e pastabilizuar mund të ndikojë në rajonin e pastabilizuar. Meqë Kosova është pjesë e

“Interesi kryesor i SHBA-së është për të gjitha vendet e Evropës Jugore e Qendrore që të jenë pjesë e tërësisë evropiane, të lira dhe në paqe.”

Misioni i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, MPP
2005

² Standardet aktuale përfshijnë themelimin dhe funksionimin e institucioneve demokratike, sundimin e ligjit, lirinë e lëvizjes, kthimin dhe riintegrimin, ekonominë, të drejtat e pronës, dialogun me Beogradin dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës.


Ballkanit, ajo ashtu është edhe pjesë e Evropës dhe integrimi i saj në ekonominë evropiane është prioriteti kyç për Qeverinë e Shteteve të Bashkuara. Kosova është një situatë unike për SHBA-në. Ajo është një bashkësi e moderuar, me mbizotërim të subjektit mysliman në Evropë, ku popullata ndjen një lidhje të veçantë me Amerikën. Shumica e kosovarëve i shohin Shtetet e Bashkuara si aktorin kryesor në dramën që i liron nga regjimi represiv i Sllobodan Millosheviqit, dhe SHBA-në e shikojnë si burimin kryesor të udhëzimeve dhe ndihmës. Përveç kësaj, në SHBA ekziston një bashkësi e madhe dhe aktive e disaporës shqiptare. Ndonëse UE-ja është burimi kryesor si i ndihmës ekonomike ashtu edhe i asaj të sigurisë, opinionit dhe këshillat amerikane po ashtu vlerësohen shumë.

Misioni i SHBA-së në planin e kryerjes së misionit në Kosovë për Vitin Financiar 2005 identifikon pesë objektiva, të arriturat e të cilëve do të japin kontribut për realizimin e interesave tona të politikës së jashtme. USAID-i ka rolin kryesor në përpjekjet për tre nga këta objektiva: *Shtimin ekonomik*, i cili synon të zhvillojë dhe të integrojë ekonominë në mënyrë më të plotë në ekonominë rajonale, evropiane dhe botërore; *Sundimin e ligjit*, i cili kërkon të vendosë dhe avancojë sundimin e ligjit, si dhe *Sistemin demokratik*, i cili orvatet të mbështesë vendosjen e institucioneve qeveritare efektive, përgjegjëse dhe të pakorrptuara, të përzgjedhura dhe të menaxhuara me parimet demokratike. Këto përpjekje konsiderohen thelbësore për të mirën ekonomike dhe politike të Kosovës dhe për stabilitetin në rajon.

USAID-i informon për strategjinë të cilën tenton të vijojë për të kontribuar në arritjen e këtyre interesave dhe e drejton atë strategji sipas vizionit të vet për Evropën dhe Evropën. Të trija elementet qenësore të Byrosë për Ndihmë Evropës dhe Evropës përfshijnë “ndihmën për vendosjen e demokracisë së plotë të rrënjësuar në sundimin e ligjit, duke furnizuar ekonomitë e tregut vital dhe duke mbështetur emergjencën e një rrjeti social përgjegjës për plotësimin e nevojave të njerëzve, sidomos të atyre me disavantazh gjatë kohës së vështirë të tranzicionit.” Këta objektiva do të arrihen në mënyrë që të afirmojnë dhe shtojnë kujdesin dhe vlerat e dinjitetit njerëzor, një koncept veçanërisht i rëndësishëm për Kosovën.

C. NDIHMA E USAID-IT DERI SOT

Ndihma e SHBA-së dhënë Kosovës ka filluar në mesin e vitit 1999, me përfundimin e konfliktit që e përzuri regjimin e Millosheviqit nga Kosova. Në fund të këtij konflikti, 38% e numrit të shtëpive kanë qenë plotësisht të rrënuara, kurse nja 20% prej tyre kanë qenë shumë të dëmtuara.³ Shumica e popullatës është detyruar t'i lëshonte shtëpitë, kurse ekonomia dhe institucionet kanë qenë në kaos. Të ardhurat për krye të banorit kishin rënë nga 1000\$ në vitin 1989 në 400\$ në vitin 1999, prodhimi industrial kishte pësuar



³ Grupi Ndërkombëtar i Menaxhmentit, korrik 1999, Raporti i anketës.

shkatërrim, kurse prodhimi bujqësor dhe blegtoral ishin dhjetuar.

Gjatë konfliktit dhe menjëherë pas tij, shumë e madhe e ndihmës humanitare është siguruar për strehim, ushqim dhe përkujdesje të nevojave themelore të një numri të jashtëzakonshëm të kosovarëve të zhvendosur dhe të varfëruar rishtas. Pas kësaj ka vijuar një program për të filluar restaurimin e jetës civile dhe ekonomike në Kosovë.

Në preiudhën trevjeçare, prej shtatorit të vitit 1999 deri në shtator të vitit 2002, mbi 174 milionë dollarë të ndihmës së USAID-it janë angazhuar për rindërtimin e Kosovës, përveç një vëllimi të madh të ndihmës emergjente që është siguruar përmes fondeve të ZNF-së. Ndihma e USAID-it ka caktuar një program për të ndërtuar vitalitetin e Kosovës duke e përkrahur UNMIK-un dhe pastaj IPVQ-në, dhe duke ndihmuar zhvillimin e sektorit privat, duke inkurajuar formimin e institucioneve demokratike dhe duke rindërtuar infrastrukturën e bashkësisë, si atë fizike ashtu edhe njerëzore. Vëmendje e veçantë u është kushtuar grupeve të rrezikuara, siç janë fëmijët dhe gratë.

Efektiviteti i rimbëkëmbjes është marramendës. Gjatë tri vjetve të ardhurat për krye të banorit janë shtuar deri përafërsisht 875 dollarë. Janë bërë përpjekje të mëdha për të vendosur një sërë politikash ekonomike dhe fiskale, duke e përcaktuar fazën për tranzicion nga ekonomia e komanduar në atë të tregut. Sistemi i buxhetit dhe i taksave po funksionon mirë, është vendosur një sistem bashkëkohor i bankave dhe ka filluar një sistem i qartë i pensioneve. Është kryer punë ekstenzive për rehabilitimin dhe rindërtimin e infrastrukturës së bashkësisë, siç janë shkollat, klinikat e shëndetit, sistemet e ujësjellësit dhe rrugët. Janë mbajtur zgjedhje të lira të vendit dhe ato komunale, është krijuar një ambient i mediave të lira dhe të hapura, kurse shoqërisë civile i është dhënë një fillim i ri.

SHBA-ja nuk ka qenë e vetmuar në dhënien e kontributit për këtë sukses, dhe në përpjekjet e rimbëkëmbjes shumë partnerë mbeten të angazhuar për krijimin e kushteve në Kosovë, të cilët mund t'u sigurojnë qytetarëve të saj një shkallë të plotë të lirisë dhe mundësi ekonomike. Suksesi i përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare e ka sjellë Kosovën në pikën ku faza humanitare dhe e rimbëkëmbjes në të vërtetë ka marrë fund. Problemi humanitar që ka mbetur është kthimi i personave të zhvendosur, kryesisht joshqiptarë, në shtëpitë e tyre ku kanë qenë ose në lokacionet sipas përzgjedhjes. Ekonomia është në buzë të zhvillimit normal. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ka nevojë për një qasje krejtësisht tjetër. Më parë del se problemet, të cilat janë hasur gjatë periudhës së strategjisë fillestare, janë trajtuar me sukses deri në atë shkallë sa që të mund të vijojë puna për vendosjen e procesit të vetëqeverisjes së qëndrueshme në fusha të rëndësishme. Do të nevojitet të sigurohen më pak mjete sesa janë siguruar në fillim për suksesin e sotëm. Mirëpo, një qasje e qëndrueshme dhe afatgjate do të nevojitet për të siguruar që ndryshimet që janë bërë të gjejnë vend në shoqëri dhe në ekonomi, në mënyrë që populli i Kosovës të përparojë, pa marrë parasysh vendimin mbi statusin e saj përfundimtar,

D. VËSHTRIM I SHKURTËR I KONTEKSTIT STRATEGJIK

1. EKONOMIA

Gjatë katër vjeteve të kaluara, kombinimi i ngritjes së shpejtësuar të institucioneve dhe politikave të shëndosha ekonomike kanë pasuar me rezultate impulsive në sferën ekonomike. Ekonomia e Kosovës po rimbëkëmbet dhe shquhet me stabilitet. Valuta zyrtare është euro, e cila ka mundur stabilizim mikroekonomik relativisht të shpejtë pas viteve të inflacionit. Kultura kosovare e aftësisë për ndërmarrje të kombinuar me fondet e donatorëve dhe shkalla e lartë e të hyrave nga diaspora shqiptare (vlerësuar në një 500 milion euro në vit) kanë siguruar një stimulim për sektorin vital privat.

Ndonëse mungesa e shënimeve statistikore zyrtare dhe të besueshme për ekonominë e bën punën të vështirë për të paraqitur një pasqyrë të saktë të ekonomisë së Kosovës⁴, analiza më e fundit e siguruar nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë e Kosovës tregon se prodhimi i përgjithshëm i vendit (PPV) është përafërsisht 1.4 miliardë euro në vit, duke u barazuar me PPV për krye të banorit prej rreth 800 euro. Megjithatë, pasi t'i shtohen kësaj të gjitha burimet e të hyrave, përfshirë edhe të hyrat prej jashtë vendit dhe të hyrat në natyrë, të hyrat e gjithmbarshme në dispozicion vlerësohen rreth 1,200 euro për person.

Vendosja e regjimit të sigurt të taksave ia ka bërë të mundur Kosovës të shkoqitet nga financimi i donatorëve gjatë tri vjetve – në vitin 2002, 95% të shpenzimeve të krijuara të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës janë financuar nga të hyrat e grumbulluara të vendit. Për më tepër, për shkak se Kosova nuk ka mundësi të ketë qasje në financim nga INF-ja, Kosova nuk ka borxh shtetëror – ndonëse negociatat për statusin përfundimtar padyshim do ta vërtetojnë nëse Kosova ka borxhe për t'i paguar kreditë e RFJ-së që janë shfrytëzuar më herët në Kosovë.

Ndonëse ka shumë aspekte pozitive të ekonomisë së Kosovës që e bëjnë të duket e fuqishme në sipërfaqe, një analizë më e thellë nxjerr në shesh dobësi dhe shmangie që e bëjnë ekonominë të rrezikuar. Së pari, e krahasuar me vendet e Ballkanit dhe pjesën tjetër të Evropës, Kosova i ilustron disa skajshmëri. Për shembull, ajo ka PPV-në më të ulët, përqindjen më të lartë të popullatës që jeton në buzë të ekzistencës, dhe pjesërisht për shkak se privatizimi ka qenë i ngadalshëm, Kosova mbetet ekonomia më “socialiste”, me faktin se sektori privat përbën vetëm 28% të ekonomisë zyrtare. Në kuptimin relativ, sektori publik në Kosovë është më i madhi në Evropë, kur të përfshihen veprimtaritë që financohen nga organizatat e donatorëve. Zhvillimi i sistemit bankar ka qenë i dalluar⁵; megjithatë, ndërmjetësimi financiar, i cili është një tregues i rëndësishëm i ekonomisë së sofistikuar, mbetet më i ulëti në Evropë.

⁴ Sistemet e mbledhjes së të dhënave të sakta janë aktualisht duke u zhvilluar. Shumë nga të dhënat që i përmban ky raport janë grumbulluar nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

⁵ Duke filluar në vitin 1999 pa asnjë bankë, sektori financiar i Kosovës është zgjeruar deri në 7 banka (2 ndërkombëtare) dhe mbi 140 degë të tyre nëpër Kosovë (duke mos llogaritur organizatat mikrofinanciare). Mbi 437 milionë euro janë në depozitet e këtyre institucioneve, të cilat aktualisht zbatojnë aksione parash si kredi të kombinuara prej 146 milionë euro.

Ekonomia e Kosovës është deri në një shkallë artificiale dhe e paqëndrueshme, meqë ajo në të shumtën udhëhiqet dhe mbështetet nga bashkësia ndërkombëtare dhe donatorët dhe nga fondet e diasporës. Veprimtaria e sektorit privat⁶ mbështetet më shumë në tregti, shërbime dhe ndërtimtari sesa në prodhimtari.

Nevoja për rindërtim pas konfliktit, krahas me praninë e bashkësisë së madhe ndërkombëtare që kërkon importe cilësore, ka dhënë si rezultat bilancin e madh negativ të tregtisë me eksportin që paraqet vetëm 3% të importit. Me tkurrjen e bashkësisë ndërkombëtare, do të pakësohet importi; dhe shumë biznese do të pësojnë nga kërkesa e zvogëluar e mallrave dhe të shërbimeve. Paraqitja e kësaj dukurie ekonomike ka qenë rezultat logjik dhe i parashikueshëm i përpjekjeve të rindërtimit të paskonfliktit dhe i strukturës unike ligjore nën RKSKB-në 1244, e cila pengon veprimtarinë ekonomike përtej Kosovës. Tani është sfidë të mbikëqyret dhe të lehtësohet tkurrja e ekonomisë gjatë disa vjetve të ardhshme përmes masave fiskale, si dhe duke ndihmuar prodhimin gjithnjë e më të madh dhe zhvillimin e tregjeve të vendit dhe të rajonit.

Reduktimi gradual i vazhdueshëm i përkrahjes buxhetore nga donatorët do ta detyrojë qeverinë qendrore të financojë me një përpjestim më të madh në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Ndonëse qeveria tani është duke ia dalur me të dalat aktuale, donatorët i kanë financuar vërtetë të gjitha të dalat kapitale. Financimi i donatorëve për shpenzimet kapitale ka qenë 38% i PPV-së në vitin 2000 dhe 34% i PPV-së në vitin 2001, të shumtën shpenzime për sektorin e energjisë elektrike. Kjo parashihet të bjerë në 8% deri në vitin 2005 dhe çdo boshllëk duhet të pritet të mbulohet me të hyrat e vendit. Përveç kësaj, meqë sistemi i taksave mbështetet shumë në tarifatat e importit, me rënien e importit do të kenë rënie edhe të hyrat nga taksat.

Privatizimi është vonuar dhe vetëm tani po fillon; në maj të vitit 2003 janë lëshuar 6 ofertat e para. Përparimi i kësaj është kufizuar që në fillim për shkak se interpretimi konservativ i UNMIK-ut për mandatin e vet për të administruar ndërmarrjet shoqërore (NSh) dhe ndërmarrjet publike (NP) ka penguar përparimin efektiv të privatizimit. Në mesin e vitit 2002, UNMIK-u ka miratuar një kornizë ligjore me përmbajtje dhe të qartë për privatizimin dhe ka themeluar Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) për t'i administruar të gjitha ndërmarrjet publike (NP) dhe ndërmarrjet shoqërore (NSh). Legjislacioni i nxjerrë për tokën në kohët e fundit sqaron dhe siguron përdorim përkatës të tokës dhe të drejtat e investuesve për transfer. Kjo vonesë e transformimit të NSh-së në ndërmarrje komerciale që mund të mbahet e ka ngadalësuar zhvillimin ekonomik në disa mënyra. Ekzistenca e vazhdueshme e NSh-së joefikase jo vetëm se vepron si një derdhje buxheti, por edhe pengon përdorimin produktiv të stabilimenteve ekzistuese dhe të parcelave të gjera të tokës që janë të bashkangjitura me të. Më tutje, pa ndërmarrje

⁶ Sektori privat është biznes i vogël i organizuar kryesisht nga familjet, me shumë pak firma të shkallës së madhe. Pjesëmarrja e industrisë në sektorin privat është nën 10%. Gjersa bujqësia paraqet rreth 20% të PPV-së (me bujqësinë dhe agrobiznesin përbëjnë rreth 25% të PPV-së), rreth 80% e ushqimit të prodhuar paraqet bujqësinë ndihmëse. Vetëm një shumë e vogël dërgohet në treg për shitje. Gjashtëdhjetë përqind të popullatës jetojnë në trevat rurale.

produktive nuk do të mund të krijoheshin vende pune në ndonjë numër të dukshëm. Me fillimin e privatizimit duhet të shpejtohet zhvillimi ekonomik.

Një problem i madh ekonomik me të cilin ballafaqohet Kosova është papunësia, sidomos papunësia e të rinjve. Shënimet statistikore për nivelet e papunësisë janë ndër më të llojllojshmet në Kosovë dhe, varësisht nga ajo si përcaktohet papunësia, këto vlerësime mund të sillen nga 35% deri në 60%. Ajo që është e sigurt, megjithatë, është se shkalla e papunësisë në Kosovë është një nga më të lartat në Evropën Juglindore. Kjo shpjegohet pjesërisht me mungesën e ndërmarrjeve prodhuese krahas me mungesën e shkathtësive për tregti të fuqisë punëtore.


Në fund, por jo edhe e fundit, janë dy kushte kryesore që pengojnë zhvillimin ekonomik: mungesa e furnizimit stabil me energji elektrike dhe çështja e statusit. Së pari, mungesa e energjisë elektrike gjatë 24 orëve është pengesë e dukshme për ata që kërkojnë të

vendosin dhe investojnë në biznese në Kosovë, sidomos për secilin që do të merret me prodhim. E dyta, statusi i papërcaktuar i Kosovës shton rreziqe të tjera për vendimet e investimeve dhe e ndërlikon aktivitetin për të ndërmarrë diçka. Çështja e statusit krijon dykuptimësi në shqyrtimet elementare siç është natyra e të drejtave të pronës, disa nga të cilat kontestohen në bazë të sovranitetit. Shumë faktorë të tjerë, përfshirë edhe çështjet lidhur me pasaportat dhe vizat, madje edhe pamundësinë për të shfrytëzuar kartelat kreditore në Kosovë, lidhen me çështjen e statusit dhe e ndërlikojnë veprimtarinë e biznesit.

2. DEMOKRACIA DHE QEVERISJA

Është bërë përparim i dukshëm drejt vendosjes së institucioneve demokratike dhe qeverisjes së mirë. Dy runde të zgjedhjeve komunale dhe zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës janë mbajtur të lira dhe të drejta. Një spektër i partive politike kanë marrë pjesë në këto zgjedhje, kurse shoqëria civile ka ndihmuar për arsimimin e votuesve dhe vëzhgimin e administrimit të zgjedhjeve. Kuvendi ka filluar të hartojë, debatojë dhe miratojë legjislacionin, kurse janë formuar dhe funksionojnë komisionet e Kuvendit me anëtarët që përfaqësojnë shumë parti dhe etnicitete. Kuvendet e komunave kanë miratuar politikat dhe rregulloret lokale. Qeveritë komunale u sigurojnë qytetarëve shërbime brenda kufijve të rregulloreve aktuale, mbledhin të ardhurat e burimeve të veta, dhe (me përjashtim të një komune) tani kanë autorizime të plota për marrjen e vendimeve mbi atë se si të shpenzojnë buxhetin e tyre komunal.

Shpërndarja e popullatës sipas moshës për punë



- Të papunë
- Të punësuar
- Te papunesuar (dekurajuar)
- Shtëpiak, studentë etj.
- Të tjerë

Burimi: Anketa e ekonomisë familjare, Riinvest, dhjetor 2002
Mbështetur në definicionet e personave të papunësuar si ata që kërkojnë punë aktivisht.

Shoqëria civile ka dëshmuar të jetë një element dinamik dhe me ndikim i qeverisjes demokratike të Kosovës. OJQ-të dhe grupet jozyrtare të qytetarëve kanë përkrahur me sukses ligjet dhe rregulloret, kanë ndikuar në vendimet e politikave, kanë marrë pjesë në bisedat publike dhe kanë kërkuar përgjegjshmëri nga institucionet dhe zyrtarët e qeverisë. Mediat private japin njoftime profesionale dhe programe informimi, bëjnë gazetari hulumtuese dhe sigurojnë përfshirje objektive të çështjeve politike dhe ekonomike.

Përkundër përparimit të dukshëm, nuk befason fakti se kultura dhe institucionet demokratike të Kosovës mbeten të dobëta dhe me rrezik nga një sërë ndryshorësh të jashtëm. Qeveria dhe Kuvendi humbin shumë kohë dhe energji për çështjen e statusit përfundimtar, ndërsa gjendja rreth riintegritit dhe pajtimit etnik mbetet e brishtë. Pjesëmarrja e serbëve në institucionet qendrore dhe komunale ndikohet shumë nga Beogradi, i cili vijon të mbështesë strukturat paralele në trevat me shumicë serbe. UNMIK-u mban kompetencat e rezervuara në shumë fusha, duke krijuar huti për kompetencat e institucioneve kosovare, si dhe konflikt midis UNMIK-ut dhe IPVQ-së.

Udhëheqësit civilë dhe politikë janë kryesisht të paprovuar dhe të papërvojë, meqë shumica e atyre që kanë udhëhequr krahinën autonome të Kosovës para vitit 1989 dhe gjatë viteve të 1990-a janë larguar. Shumë politikanë të rinj nuk kanë pasur kompetenca të duhura politike përpara dhe janë të pasigurt si të veprojnë. Qytetarët kanë përvojë të pakët me kulturën demokratike dhe shpesh janë të pasigurt për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe për ato të zyrtarëve të zgjedhur.

Korniza themelore legjislative ende është në fillim, me ligjet dhe kodet kyçe ende të pamiratuara, dhe shpesh të hartuara me kontribut të kufizuar nga kosovarët. Për shembull, nevojitet një numër i ligjeve të reja lidhur me zgjedhjet. UNMIK-u ende pohon se zgjedhjet janë e drejtë e tij e rezervuar, dhe shumë qytetarë janë të brengosur për mungesën e pjesës kosovare në procesin e hartimit të akteve. Ndonëse zgjedhjet e kaluara kanë qenë të lira dhe të drejta, ka nevojë për një reformë të një kornize të zgjedhjeve të Kosovës për të siguruar përfaqësim më të mirë të nevojave zgjedhore dhe që partitë politike të kenë më shumë përgjegjshmëri. Si në shoqëritë e tjera në tranzicion, partitë politike mbështeten më shpesh në një person sesa në program, dhe u mungon transparenca dhe përgjegjshmëria ndaj popullit. Kjo e dëmton legjitimitetin e tyre dhe ndikon në cilësinë e procesit demokratik.

Ndonëse është bërë përparim i dukshëm në reformimin e sistemit të drejtësisë, një kompetencë tjetër kjo e rezervuar e UNMIK-ut, përsëri mbeten probleme të dukshme. Sipas UNDP-së, shumica e kosovarëve është e pakënaqur me gjykatat. Një anketë e vitit 2003, e bërë nga Index Kosova, ka treguar se nga 28 institucione, gjyqësia konsiderohet

Mendimi publik në Kosovë Shtator 2002 – prill 2003		
Treguesi	Shtat – dhjet 2002	Jan – prill 2003
Të kënaqur me punën e UNMIK-ut	57.8%	51.9%
Të kënaqur me punën e PSSP-së	67.3%	64.4%
Të kënaqur me punën e Qeverisë	69.1%	74.9%
Të kënaqur me punën e Kuvendit	73.1%	71.9%
Optimistë për mirëqenien ekonomike të familjes	66.0%	48.5%
Burimi: Anketa për mendimin publik të SVH, UNDP		

të jetë institucioni i dhjetë i më të korruptuarve. Rrogat e ulëta, mungesa e qasjes në legjislacion, administrata gjyqësore joefikase dhe besimi i ulët publik, të gjitha këto e dëmtojnë integritetin dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor.

Në nivelin lokal, qeverive komunale u është dhënë më shumë kontroll mbi buxhetet e tyre por janë rreptësisht të kufizuara në përmbushjen e shumë funksioneve që zakonisht i kryejnë qeveritë lokale. Disa shërbime themelore, si policia dhe sigurimi, janë kompetenca të rezervuara të UNMIK-ut; Agjencia Kosovare e Mirëbesimit dhe organet e tjera të UNMIK-ut e mbajnë kontrollin mbi shërbimet publike, ndërmarrjet shoqërore dhe pronat e komunave; kurse rregulloret dhe legjislacioni që u përkasin kompetencave të qeverisë komunale janë shpesh të zbehta dhe konfuze. Megjithatë, madje edhe kur kompetencat e komunave janë përcaktuar qartë, zyrtarëve komunalë shpesh u mungojnë shkathtësia dhe burimet për të kryer punën e tyre me efikasitet. Ndonëse komunat janë duke i grumbulluar të hyrat e burimeve të tyre vetanake, mundësia e tyre për t'i plotësuar nevojat e tyre financiare të komunës rrezikohen nga ekonomia e dobët, papunësia e madhe, mungesa e investimeve dhe ambienti i pafavorshëm për zhvillimin ekonomik lokal. Më tutje, sa më shumë kompetenca t'u dorëzohen zyrtarëve komunalë, do të nevojiten mekanizma aq më të fuqishme për të siguruar transparencën dhe përgjegjshmërinë dhe për t'i minimizuar gjasat për korrupsion.

Vonesat për zgjidhjen me sukses të problemeve ekonomike të Kosovës e pengojnë edhe zhvillimin e mediave dhe të shoqërisë civile të Kosovës. Mediat publike dhe private varen shumë nga donatorët ndërkombëtarë për financimin e mbijetesës së tyre, duke shtuar brengat për mundësinë e tyre që të mbajnë pavarësinë e redaktimit për një afat të gjatë. Nevojitet legjislacion i ri për të mbrojtur pavarësinë dhe mundësinë për të jetuar mediat dhe për të siguruar rregullativë të duhur të këtij sektori. Gazetarët dhe media ende kanë nevojë të përmirësojnë profesionalizmin, kurse organizatat e mediave kërkojnë ndihmë për menaxhimin e biznesit. OJQ-të dhe grupet e qytetarëve kanë pasur sukses për të ndikuar në vendimet e politikës, por ende u mungojnë shkathtësitë elementare për të vepruar si vëzhgues efektivë dhe për ta angazhuar qeverisjen në nivel më të stërholluar.

“Kosovarët duhet të angazhohen më shumë në çështjet politike në përgjithësi, për t'u ndihmuar udhëheqësve të tyre...Ata duhet të sigurohen që të dëgjohen institucionet tona. Nuk mund të kemi demokraci nëse populli nuk i ushtron të drejtat e veta, dhe nëse ata që emërohen për t'i shërbyer popullit nuk veprojnë sipas dëshirës së tij. Kjo është një formulë e thjeshtë por e domosdoshme për Kosovën”
Bajram Rexhepi, Kryeministër i Kosovës. mars 2003

E. FAKTORËT E TËRTHORTË QË NDIKOJNË NË STRATEGJI

1. Konflikti

Kosova ka vetëm katër vjet të rimbëkëmbjes së vet nga konflikti me bazë dhune që e ka shquar lëvizjen masive të popullatës civile dhe shkatërrimin e infrastrukturës. Është arritur përparim nga kaosi deri në kushtet e tashme për t'iu qasur jetës normale, por ende ka vend për brenga. Ndonëse përsëritja e konfliktit të armatosur konsiderohet shumë e pa gjasa, ditë për ditë vazhdojnë kërcënime dhe incidente të izoluara të dhunës. Tensionet etnike ende qëndrojnë nën sipërfaqe të cekët; hiq më pak se 200,000 individë mbeten të zhvendosur nga shtëpitë e tyre; liria e lëvizjes për popullatën pakicë po përmirësohet, por

ende duhet të konsiderohet e kufizuar; papunësia është endemike kurse ekonomia ende përkrahet nga organizatat ndërkombëtare dhe nga të hyrat e grupeve të diasporës shqiptare; kurse organizatat kriminale rajonale janë aktive. Sigurimi bëhet nga KFOR-i, CIVPOL-i dhe gjithnjë e më shumë nga Shërbimi Policor i Kosovës. Ndonëse gradualisht po përmirësohet, gjendja e sigurisë konsiderohet e brishtë nga shumica e popullatës, sidomos nga pakicat.

Si mjet për vëzhgimin dhe gjurmimin e burimeve të shumta potenciale të konfliktit, UNDP-i, me ndihmën e USAID-it, ka paraqitur një sistem të vërejtjes së hershëm (SVH) të Kosovës, mbështetur pjesërisht në sisteme të ngjashme të zbatuara në vendet fqinje.

Përafërsisht në çdo katër muaj bëhen anketa. Vëzhgohen vanzhdimisht 17 fusha të problemeve potenciale, që pasqyrojnë potencialin e perceptuar të çdo fushe për provokim të konfliktit. SVH-ja po tregon vëmendje gjithnjë e më madhe dhe rezultatet e saj janë duke u shfrytëzuar gjithnjë e më shumë si burim për diskutim dhe analizë. UNDP-i ka paraqitur sesione në një tryezë të rrumbullakët me pjesëmarrje të mirë, ku përfaqësues të ndryshëm të ndërkombëtarëve dhe të bashkësive kosovare diskutojnë për rezultatet dhe rekomandimet. SVH-ja do të vazhdojë deri në vitin 2005, duke siguruar informacione të dobishme për nxitësit kryesorë të konfliktit dhe do të shërbejë si burim i vazhdueshëm i referencave për veprimtarinë e USAID-it. (shih shtojcën 4.3)

Kthimi dhe riintegrimi

Një prej nxitjeve më të mëdha për konflikt është çështja shumëanësore e kthimit dhe e riintegritit të pakicave. Numri i saktë i njerëzve të zhvendosur është iluziv.⁷ Mirëpo, UNHCR-i vlerëson se ka rreth 22,000 PZhBV⁸ në Kosovë dhe 235,000 jashtë Kosovës (kryesisht serbë dhe malazezë); shumica e PZhBV-ve janë serbë, por ka edhe pakica të tjera dhe shqiptarë. Numri i të kthyerve në

Anketa opinioni mbi raportet etnike			
Nëntor 2002 /mars 2003 (%)			
	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë
Raportet të tendosura; do të mbeten ashtu	34/42	69/73	35/14
Raportet të tendosura, por ka përmirësime kohës së fundit	36/37	18/18	37/62
Raportet të tendosura, por ka përmirësim të dukshëm	17/10	10/7	24/16
Raportet jo aq të tendosura	10/7	2/1	4/8
Raportet jo të tendosura	3/5	1/0	0/0
Raporti për vërejtjet e hershme, prill 2003			

⁷Numri i saktë i personave aktualisht të zhvendosur është i ndryshëm meqë këta numra mund t'u nënshtrohen manipulimeve politike dhe nuk ka pasur mekanizëm të qartë për t'i grumbulluar të dhënat e sakta.

⁸UNHCR-i i përcakton PZhBV-të si qytetarë të cilët janë detyruar t'i braktisin shtëpitë e tyre si rezultat i konfliktit të armatosur, dhunës, shkeljes së të drejtave të njeriut, ose shkatërrimeve natyrore ose të njeriut, ose për t'u ikur këtyre, megjithatë nuk e kanë kaluar ndonjë kufi të njohur ndërkombëtarisht. Ky definicion i referohet popullatës së zhvendosur të Kosovës që janë duke banuar në Serbi ose Mal të Zi, si dhe atyre që banojnë brenda kufijve të Kosovës.

Kosovë ka qenë i vogël gjatë tri vjetve të kaluara, ata që vijnë gati barazohen me ata që dalin. Rreth 2,700 të kthyer janë shënuar në vitin 2002, duke e bërë vitin e parë me një ardhje të pastër.⁹

Në shumë studime është shqyrtuar çështja e kthimit. Misioni para do kohe ka bërë vlerësimin e vet të këtij problemi (shih shtojcën 5.4). Studimi ka konkluduar se shumë PZhBV kanë shfaqur dëshirën për t'u kthyer, por janë penguar nga realiteti i kthimit në shtëpitë e shkatërruara dhe nga vështirësitë sociale-ekonomike, si mungesa e punësimit dhe mungesa e shërbimeve përkatëse shëndetësore dhe shkollore. Ndonëse shpesh kanë kushte të mjerueshme të jetesës në lokacionet e zhvendosjes, të cilat kanë qenë arsye e mjaftueshme për kthim, arsyeja kryesore për hapin e ngadalshëm të kthimit ka qenë mungesa e vendeve të punës dhe mundësitë ekonomike.

Faktorët e tjerë që potencialisht e ngadalësojnë kthimin përfshijnë edhe angazhimin e zyrtarëve komunalë në procesin e kthimit, mungesën e pranueshmërisë nga shumica në bashkësitë e kthimit, rrethanat e pasigurta të kushteve dhe qëndrimet shpeshherë të transmetuara nga mediat serbe që i frikësojnë njerëzit e zhvendosur, mungesën e një kornize ligjore koherente për t'i zgjidhur ngatërresat pronësore, si dhe proceset e rënda të instaluar nga bashkësia ndërkombëtare për angazhimin për të ndihmuar kthimin. Ndonëse sigurimi është theksuar si një faktor i rëndësishëm i shumë PZhBV-ve, ekipi ka ardhur në përfundim se perceptimi i gjendjes së sigurisë është më i keq sesa realiteti, dhe u ka dhënë nota të larta Shërbimit Policor të Kosovës dhe KFOR-it.

Nga vlerësimi del përfundimi se USAID-i mund të kontribuojë më së miri për mundësinë e kthimit dhe të riintegritit të qëndrueshëm përmes theksimit të programeve që i forcojnë institucionet lokale, avancojnë qeverisjen demokratike dhe pjesëmarrjen e qytetarëve dhe ndërtojnë ekonominë e qëndrueshme me mundësi të avancimit të punësimit. Përveç kësaj, ofrimi i projekteve të infrastrukturës së bashkësive që e inkurajojnë kthimin dhe lehtësojnë riintegrimin është një element i rëndësishëm për krijimin e ambientit të favorshëm për kthim. Krijimi i kushteve që e ndihmojnë punësimin, ndihmën e mediave për të krijuar një sistem më të hapur, zhvillimin e një sistemi juridik koherent dhe angazhimi i shtuar i zyrtarëve komunalë në këtë proces janë themelore dhe e ndihmojnë shpejtimin e procesit të kthimit dhe të riintegritit.

Mirëpo, pa marrë parasysh gjithë vullnetin e mirë në botë, kuptimi i vlerësimit është se konflikti është aq i freskët dhe armiqësitë janë aq të thella saqë duhen shumë vjet para se të mund të shpresohet të arrihet zgjidhje kuptimplote. Pasiguria mbi statusin përfundimtar të Kosovës me siguri paraqet një frenim për pajtim sa i përket pakicës serbe. Riintegrimi është përpjekje e përditshme i bërë me hapa të vegjël nëpër të gjitha nivelet dhe aspektet e shoqërisë. Në sektorët ku punon USAID-i, është e domosdoshme të sigurohet që këta hapa të identifikohen dhe zbatohen. Ne mundemi, për shembull, të sigurojmë që Kuvendit multietnik t'i jepen mjete për të funksionuar me efikasitet, që pakicat të mund të kenë fjalën në qeveri, dhe që informimi të jetë i lirë dhe i paanshëm.

⁹ Vlerësimet e UNHCR-it. Ky numër mund të jetë dukshëm më i lartë meqë nuk janë regjistruar të gjithë të kthyerit.

Po ashtu mund të vazhdojmë të përkrahim komunat që t'i plotësojnë kërkesat për ndarjen e drejtë të financimit, legjislacionin e sponsoruar nga UNMIK-u i cili kërkon që çdo komunë të shpenzojë përqindjen e buxhetit të vet për programe nga të cilat përfiton drejtpërdrejtë popullata joshumicë. Duhet t'i bëjmë këto përpjekje për të krijuar kushte pozitive për riintegrim, duke mos e ndalur shpejtësinë në mënyrë që vetë kosovarët të ndër marrin hapa të mëtejshëm.

2. Korrupsioni

Një vlerësim mbi korrupsionin në Kosovë, i kryer në maj të vitit 2003, ka studiuar thellësinë e këtij problemi dhe ka identifikuar cenimet kyçe dhe aftësinë e institucioneve për të kontrolluar këtë problem. Fushat që janë shqyrtuar përfshijnë administratën publike dhe shërbimet publike, legjislaturën, sistemin e drejtësisë dhe zbatimin e ligjit, shoqërinë civile, sektorin privat, mediat dhe komunat.

Vlerësimi ka nxjerrë si përfundim se, ndonëse ekziston korrupsioni, duket se ai nuk e ka penguar mundësinë të qeveriset as që është aq i përhapur ose shkatërrues siç u duket vëzhguesve të rastit të shoqërisë ballkanike. Në një anketë para do kohësh të bërë nga Index Kosova, Kosova ka shënuar më pak pikë sesa të tetë fqinjtë e Ballkanit në gjashtë nga dhjetë indicje të korrupsionit, dhe ishte e krahasueshme me vendet e tjera në dy indicjet e tjera.

Vlerat e Indeksit për korrupsion (mbështetur në nivelet e indeksit 1 – 10)							
Vlerat e korrupsionit sipas Indeksit (mbështetur në nivelet e indeksit 1 – 10)	Pranueshmëria në parim	Prekshmëria nga korrupsioni	Përfshirja në praktikën e korrupsionit	Trysnia për korrupsion	Përhapja e korrupsionit	Efikasiteti praktik për korrupsion	Parashikimet për korrupsion
Shqipëria	2.4	4.5	2.0	3.4	7.0	6.6	5.5
Bosnja dhe Hercegovina	2.0	2.9	1.5	2.5	6.0	5.9	5.0
Bullgaria	1.3	2.7	0.3	1.0	6.4	6.9	5.8
Maqedonia	2.4	3.0	1.6	2.3	6.8	6.1	6.1
Rumania	1.9	3.7	1.1	1.9	6.9	7.1	6.2
Kroacia	2.2	2.6	0.6	1.4	5.3	5.8	4.8
Serbia	2.0	2.7	1.4	2.2	6.0	6.5	5.1
Mali i Zi	1.5	2.6	1.0	1.8	6.0	6.7	4.5
Kosova	2.1	2.8	0.7	1.1	4.9	3.9	3.8

10 – Korrupsion shumë serioz, i dukshëm 0 – “Shoqëri pa korrupsion” Anketa e korrupsionit në Kosovë

Ekziston potencial i konsiderueshëm që korrupsioni të bëhet ndikim i dukshëm në Kosovë, nëse nuk merren masa për t'i zgjidhur disa dobësi të segmenteve ekonomike, civile dhe të sundimit të ligjit në shoqëri, sidomos për shkak se UNMIK-u transferon kompetenca të mëdha tek IPVQ-ja. Tërvat potencialisht problematike janë privatizimi dhe ndërmarrjet shoqërore dhe publike, mbledhja e taksave dhe regjistrimi. Disa nga sistemet administrative të reja e të mëdhaja që janë instaluar nga donatorët, si dogana, do të jenë efektive vetëm nëse zbatimi i tyre përkatës sigurohet me ndihmën e vazhdueshme të donatorëve.

Misioni ka nxjerrë përfundimin se ndonëse tani nuk ka prioritet për qytetarët, mundësia se do të ketë vështirësi është mjaft e madhe, sa që e arsyeton zgjidhjen e korrupsionit

përmes aktiviteteve nga portofoli. Së këndejmi, ndonëse nuk është aktivitet i pavarur, çdo objektiv strategjik do të përmbajë elemente që lidhen me përpjekjet për të zgjidhur korrupsionin – transparenca dhe përgjegjshmëria do të jenë penj të thurur nëpër strategji. Për shembull, ndihma në sektorin ekonomik do të vërë në shënjestër krijimin e mekanizmave për të siguruar që sistemet që janë duke u instaluar të mund të kenë revizion dhe të kontrollohen nga organet e pavarura. Programet e demokracisë dhe të qeverisjes do të përfshijnë veprimtari që shtojnë konsekuencën, transparencën dhe efikasitetin e sundimit të ligjit dhe të procedurave të qeverisjes, duke e forcuar pavarësinë e gjyqësisë dhe duke shtuar aftësinë e shoqërisë civile dhe të mediave për të shërbyer si vëzhgues të korrupsionit. (shih shtojcën 4.2)

Vendosja e gjithë strategjisë do të jetë një parim që trajnimi i cili paraqitet në përcjellje të objektivave t’i senzibilizojë menaxherët e rinj, qoftë publikë ose privatë, për parimet, vlerat dhe etikën të cilat duhet të jenë të pranishme për t’iu kundërvënë korrupsionit në transaksionet e përditshme. Qëllimi, pra, do të jetë të institucionalizohen praktikat më të mira të qeverisjes së mirë dhe të pengohet korrupsioni, i cili mund të pengojë përparimin demokratik dhe ekonomik të Kosovës.

3. Rinia

Popullata e madhe e rinisë në Kosovë paraqet shumë probleme për të ardhmen, të cilat duhet të trajtohen sot. Rreth 60% e popullatës aktuale është nën moshën 25 vjeçe, kurse një e treta e kësaj popullate është nën moshën 15 vjeçe, me popullatën rurale e cila është pak më e re për shkak të shkallës më të lartë të lindjeve. Për dallim nga kjo, individët 65-vjeçarë e më të moshuar paraqesin vetëm 5.5% të popullatës.¹⁰ Demografia unike e bën “faktorin e rinisë” shumë të rëndësishëm për të siguruar sukses në të gjitha përpjekjet për zhvillim.

Rinia ka nevojë për arsim më të mirë dhe për shkathtësi të avancuara për t’u marrë me trysnitë ekonomike dhe sociale dhe për të mundur të marrë qëndrim aktiv në zgjidhjen e pengesave të rritës së saj dhe të përfshirjes së saj në shoqëri. Rrjetet sociale, arsimore dhe ekonomike si dhe institucionet për rininë kërkojnë ndihmë të dukshme për t’u bërë plotësisht funksionale.

Si anë pozitive është se ka një shkallë të konsiderueshme të optimizimit ndërmjet rinisë kosovare. Sipas Raportit mbi hulumtimin e rinisë të PRONI-t, në dhjetor të vitit 2002, 39% e rinisë së Kosovës presin që jeta e tyre do të jetë e mirë në të ardhmen, kurse 24% mendojnë se ajo do të jetë e shkëlqyeshme, përkundër vështirësive të tashme. Të rinjtë e Kosovës nuk planifikojnë të largohen në numër masiv për të kërkuar mundësi më të mira, siç është dukuri gjetiu në rajon. Një përjashtim i madh i migrimit është në vijim e sipër nga fshati në qytet – 63% e rinisë së Kosovës beson se qyteti ofron kushte më të

“Gjithmonë kam menduar se udhëheqja nuk ka të bëjë me mua, se vetëm politikanët e interesuar vetë kanë qenë udhëheqës. Tani kuptoj se udhëheqja është e gjitha ajo mbi qytetarin – marrja e përgjegjësisë dhe iniciativës dhe sjellja në komunitetin dhe vendin e punës, mënyrat e reja si të shikohen dhe bëhen punët që janë për të mirën e të gjithë njerëzve.”

Myesere Hoxha, Klasa 3 ‘Hope Fellow’

¹⁰ PRONI – Instituti për Arsimin Shoqëror. Dhjetor 2002

mira të jetesës. Në fund, rinia e Kosovës ka një besim relativisht të madh në organet e IPVQ-së, siç janë Presidenti (45.7%) dhe Qeveria e Kosovës (42.7%). Është e domosdoshme të punohet në ecuritë dhe qëllimin ekzistues pozitiv për angazhimin e rinisë në mënyrë kuptimplote përmes programeve sociale, politike dhe ekonomike.

Rinia duhet të ketë zërin e vet për formimin e së ardhmes së vet dhe mundësinë për të zhvilluar vlerat shoqërore dhe shkathësitë e nevojshme për të kontribuar në mënyrë efektive në jetën civile. Të mos përfillet ndikimi potencial negativ i një numri të madh të të rinjve të pavyeshëm dhe ekonomikisht të patreg do të ishte, thënë më së buti, marrëzi. Si temë e tërthortë, me trajtimin e rinisë si partner dhe përfitues të programeve të USAID-it, rinia mund të përfshihet në një spektër të gjerë programesh – që nga zgjidhja e nevojave për trajnim që u siguron qasje në mundësitë ekonomike, deri në sigurimin e aktiviteteve që u japin mundësi për qasje në diskutimet e politikave dhe në postet e udhëheqësve në partitë politike, në shoqërinë civile dhe në asociacionet e biznesit.

4. Gjinia

Në Kosovë, si në shumë vende, mbizotëron kultura patriarkale, në të cilën gratë kanë qenë tradicionalisht të marginalizuara dhe kanë pësuar diskriminim. Kjo vlen sidomos për trevat rurale. Në vitet e fundit, megjithatë, shumë vëmendje i është kushtuar zvogëlimit të diskriminimit dhe krijimit të mundësive më të mëdha për gratë.

Përparim i dukshëm drejt barazisë gjinore është bërë në arenën politike, sepse si UNMIK-u ashtu edhe IPVQ-ja kanë caktuar poste ekskluzivisht për çështjet e grave. Kushtetuta e Kosovës bën "Marrëveshjen për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave" (MEDG) të zbatueshme në Kosovë. Ky dokument (MEDG) tani është duke u përdorur dhe paraqet një mjet të fuqishëm ligjor për përkrahjen dhe avancimin e interesave të grave. OSBE-ja ka përcaktuar kuotën e gjinisë prej 30% për gratë në sistemin zgjedhor me lista të mbyllura. Me lëvizjen e dukshme për reformimin e sistemit zgjedhor, çështja e ruajtjes së përqindjes së lartë të grave në postet e zgjedhura është identifikuar si një nga objektivat kryesorë në Planin e veprimit për barazinë e gjinive, i cili është përpiluar nga ekspertët kosovarë me ndihmën e USAID-it dhe të UNIFEM-it. Misioni do të vazhdojë të përqendrohet në rolin e përparuar dhe të rritur të grave përmes punës së vet në avancimin e institucioneve demokratike të shoqatës vitale civile dhe të qeverisjes më të mirë lokale. Ndonëse gjinia do të trajtohet si temë e tërthortë në portofol, Misioni do të vazhdojë aktivitetin e vet të pavarur të përqendruar në trajnimin e udhëheqjes të grave dhe të zhvillimit të OJQ-ve.

Përparimi i grave në fushën ekonomike nuk është shumë i dukshëm. Më shumë të reja sesa të rinj janë të papunë. Gratë po ashtu përpiqen të hyjnë më vonë në tregun e punës dhe janë më pak të përgatitura. Vetëm 6% nga 50,000 biznese janë regjistruar në emër të grave dhe vetëm 6% të pronës së paluajtshme e zotërojnë gratë. Këto shifra, megjithatë, mund të fshehin rolin më të fuqishëm të grave ndërmarrëse që punojnë në ndërmarrjet familjare. Është e qartë se ka vend për përmirësim. Aktivitetet e Misionit në sektorin privat do të shqyrtojnë si papunësinë ashtu edhe mungesën e shkathësive menaxheriale,

që pastaj do të pasojë me më shumë gra të përgatitura dhe të angazhuara në aktivitetet ekonomike produktive.

Në fund, Kosova është një pikë tranzitore për trafikimin e grave. Ndonëse shënimet tregojnë se pak gra të trafikuar janë nga Kosova, ai numër i vogël si duket po shtohet. Edhe pse kjo ecuri mund të jetë pasojë e faktit se më shumë gra dëshirojnë të kërkojnë ndihmë, nuk ka vend për vetëkënaqësi. Meqë ka ligje të shkruara që parashikojnë dënime të rrepta për ata që eksploatojnë gratë, puna e USAID-it me qeverinë qendrore dhe ato lokale do t'u bëjë të mundur të punojnë më mirë për eliminimin e trafikimit të jashtëm si dhe të shqyrtojnë çështjen e njohur të grave të trafikuar në mënyrë ndërkombëtare dhe të viktimave të prostitucionit të detyruar.

5. Zhvillimi i aftësisë njerëzore

Kosovarët janë aktualisht të pozicionuar dobët, qoftë të inicojnë ose të mbajnë zhvillimin ekonomik substancial. Ndonëse mund të vendoset një ambient i mundshëm, mbetet fakti se shumicës së qytetarëve u mungon shkollimi ose trajnimi i nevojshëm për të qenë ndërmarrës, menaxherë dhe për të zhvilluar ekonominë e fuqishme. Me humbjen e autonomisë në vitin 1989, shumica e shqiptarëve etnikë është nxjerrë nga punët në shërbimet publike dhe shumë nga të shkolluarit mirë kanë mbetur të gjejnë mundësi punësimi jashtë Kosovës. Shumë shqiptarë kosovarë të rinj janë larguar nga sistemi i shkollimit zyrtar dhe kanë filluar të marrin pjesë në sistemin paralel të arsimit me financim të dobët e me numër të madh nxënësish e studentësh. Ndonëse vlerësohet se mbi 93% të të rriturve dinë shkrim e lexim, ka zbrastësi të dukshme të barazisë, sidomos në trevat rurale të grupeve dhe të grave të pakicave (joserbe). Ndonëse femrat paraqiten baraz me meshkujt në nivelin e shkollave fillore, ka një rënie të dukshme të vijimit të shkollave të mesme nga femrat shqiptare. Nga grupet joserbe, grupmosha e sotme prej 16-25 vjeçe ka më pak shkollë sesa ata të moshës midis 26-45 vjeçe. Vlerësohet se vetëm 17% e tyre shkojnë në arsimin e msëm.¹¹

Ka nevojë për zhvillimin e aftësisë njerëzore në të gjithë sektorët dhe nivelet. Tranzicioni i Kosovës nga provinca më e varfër në ish-Jugosllavi deri në demokraci të zbatueshme dhe plotësisht funksionale e me orientim nga tregu varet nga aftësia e kosovarëve si për ta udhëhequr shndërrimin dhe për të qëndruar në të. Trajnimi dhe arsimiti, pra, formojnë një temë të rëndësishme të tërthortë dhe formojnë bërthamën e shumë përpjekjeve që duhet të bëhen për ndihmë.

F. PRIORITETET STRATEGJIKE DHE DREJTIMET E PROGRAMEVE

1. Qëllimi

Qëllimi i përgjithshëm i USAID-it për Kosovën është ta bëjë atë një subjekt demokratik, vetëqeverisës, ekonomikisht të qëndrueshëm, në të vilin të gjithë qytetarët të kenë mundësi dhe të drejta të barabarta. Në dekadën e fundit të shkatërrimit dhe lënies pas dore, në të vërtetë, nuk ka mbetur pa u prekur asnjë element i shoqërisë. Pengesat e kapacitetit strukturor dhe njerëzor të shkaktuara nga konflikti, kur të kombinohen me

kërkesat e tregut dhe të tranzicionit shoqëror, të cilat ndikojnë në të gjitha vendet në këtë rajon, krijojnë një nevojë shumë të madhe për zhvillimin e Kosovës. Si njëri nga shumë donatorë, USAID-i ka bërë zgjidhje të vështira se ku duhet të ndërhyjë me efikasitet më të madh për të mundur të ndihmojë këtë ambient. Vendimi, mbështetur në analiza ekstenzive, në konsultime me një spektër të gjerë të palëve të interesuara dhe në përvojën e viteve të kaluara të angazhimit në Kosovë, kanë shpjerë në përqendrimin e tij në dy fusha të gjera – në zhvillimin ekonomik dhe në demokraci dhe qeverisje.

Objektivat e USAID-it për zhvillimit ekonomik janë që të stimulojë zhvillimin ekonomik duke avancuar integrimin e ekonomisë në rajon, duke inkurajuar investimet në prodhim në Kosovë dhe duke krijuar mundësi për punësim të ri të qëndrueshëm. Janë dy parakushte të gjera që duhet të plotësohen nëse duhet të arrihen këta objektiva. I pari është të vendosen institucionet, praktika dhe politikat që inkurajojnë dhe mbështesin investimet. I dyti është të punohet drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë intensive me bizneset për të krijuar një sektor privat dinamik, konkurrues dhe të zgjerueshëm. Statistika tregon se varfëria është e përhapur por jo e thellë, me rreth 50% të kosovarëve duke jetuar nën linjën e varfërisë, 12% në varfëri të skajshme¹². Prandaj, USAID-i/Kosova nuk do të zbatojnë projekte të drejtuara posaçërisht për zbutjen e varfërisë, por më parë me qëllim të stimulimit të zhvillimit ekonomik, i cili do t'u sigurojë kosovarëve mundësi dhe potencial më të madh për të ardhura.

Në fushën e demokracisë dhe të qeverisjes, qëllimi i përgjithshëm i USAID-it është që të ketë më shumë zyrtarë të aftë dhe përgjegjës të qeverisë që veprojnë sipas sundimit të ligjit, duke përfaqësuar interesat e qytetarëve dhe siguruar qeverisje transparente, të përgjegjshme, të drejtë dhe efektive e të mbështetur në kontributin e qytetarëve, të bashkësive dhe të medias. Sa i përket zhvillimit ekonomik, janë dy parakushte të gjera që duhet të plotësohen në mënyrë që të arrihet ky qëllim. Së pari, qeveria duhet të jetë e qasshme dhe transparente për publikun, përgjegjëse për nevojat dhe veprimin në përputhje me sundimin e ligjit në mënyrë të parashikuar. Së dyti, lipet të ketë një partneritet sinergjik midis shoqërisë civile të informuar mirë dhe aktive dhe një qevrie të aftë dhe të përgjegjshme. Këta dy objektiva strategjikë në këtë fushë do të veprojnë drejt arritjes së sistemeve demokratike të avancuara dhe stabile të qeverisjes, të mbështetura në shoqërinë civile vitale.

2. Përqëndrimi

Misioni do të përqendrohet në kërkimin e katër objektivave strategjike, dy objektiva të veçantë dhe një objektiv i përkrahjes së programit gjatë periudhës së strategjisë. Në bazë të lëvizjes pozitive nga supozimet e gjera të përvijuara dhe të përfshirjes së vazhdueshme të bashkësisë së donatorëve, Misioni gjykon se të gjitha rezultatet e theksuara mund të arrihen gjatë pesë vjetve të periudhës së planit strategjik.

Zhvillimi ekonomik:

Strategjia aktuale trevjeçare e tranzicionit për Kosovën përqendrohet në krijimin e strukturave themelore që nevojiten për zhvillimin ekonomik. [OSI.3 – Përcaktimi i

¹² Anketa e bërë në shtator – dhjetor 2001

politikës ekonomike dhe korniza institucionale që lehtëson rimbëkëmbjen dhe zgjerimin e ekonomisë së zhvilluar në sektorin privat]. Gjatë katër vjetve, është bërë përparim substancial në përcaktimin e asaj kornize. Pos përfundimit të reformave të politikës, ajo detyrë tani kthehet në zbatim dhe institucionalizim. Përqendrimi në objektivat ekonomike kështu kthehet në “kosovarizim” të institucioneve të politikës kyçe të ekonomisë dhe të zbatimit të atyre politikave, ligjeve dhe reformave të bëra. Mbështetja me bazë të gjerë, e cila është siguruar për sektorin privat, do të ngushtohet paksa kështu që mund të sigurohet ndihmë më intenzive në sektorët kyç.

O.S. 1.2 – Politika dhe klima institucionale e përmirësuar për investime në prodhim është më e gjera dhe më themelore e objektiveve ekonomike. Arritja e këtij objekti do të sigurojë kornizën për zhvillimin ekonomik në bazë të tregut, që do të mundësojë vetëmjaftueshmëri dhe do t’i mundësojë Kosovës t’i arrijë aspiratat e saj ekonomike në ambientin e tregut të lirë. Me këtë objektiv strategjik, ambienti i politikës dhe ai ligjor do të gjejnë vendin e vet, pengesat e eksportit do të zhduken, do të përfundohet puna mbi buxhetin bashkëkohor, mbi sistemet e taksave dhe të financave dhe do të privatizohen mjetet e pronës shoqërore. Do të gjejnë vend mbështetjet ligjore të nevojshme për aktivitetin komercial dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve komerciale.

O.S. 1.3 – Rritja e shpejtuar e sektorit privat i përqendron mjetet e Misionit për përmirësimin e efikasitetit bujqësor, aftësinë ndërmarrëse dhe kushtet e punës së biznesit si të hyra për krijimin e punësimit dhe për efikasitetin e shtimit ekonomik. Ndihma e USAID-it do të përqendrohet në teknologji, në standardet e prodhimit ndërkombëtar dhe në planet e biznesit të avancuar, si rrugë për përmirësimin e menaxhmentit, për racionalizimin e veprimeve dhe tërheqjen e investimeve kapitale në shkallë efikase (si të vendit ashtu edhe të jashtme). Përqendrimi i dytë do të jetë në mbështetjen e asociacioneve të biznesit dhe të organizatave të tjera, duke e shtuar mundësinë e tyre për të siguruar kontribut kuptimplotë për zhvillimin e politikës ekonomike dhe të ligjit. Kjo përpjekje do të ndihmojë që të sigurohet një ambient i veprimit që mbështet krijimin e biznesit, zgjerimin e tregut dhe investimet racionale.

Demokracia dhe qeverisja:

Si në fushën ekonomike, ndihma e deritashme me programet e demokracisë dhe të qeverisjes është përqendruar në vendosjen e strukturave themelore të reformës dhe të institucioneve demokratike [OS2.1 *Qeverisja e përgjegjshme dhe transparente*]. Tani ka nevojë të konsolidohen ato që janë bërë, sidomos në zgjedhje dhe media. Me kalimin e ndihmës së drejtpërdrejtë në infrastrukturën e bashkësisë [OS3.1 *Gjendja normale e vendosur për standardet dhe mundësitë e jetesës*] dhe me kapitalizimin e përparimit të bërë në decentralizim, fusha kryesore e re e përqendrimit të programeve të qeverisjes do të jetë krijimi i kadrove në nivelin lokal dhe mobilizimi i partneritetit efektiv midis zgjedhësve lokalë.

O.S. 2.1 – Shoqëria civile dhe qeveria që janë partnerë më efektivë për të arritur qeverisje të mirë janë objektivi i parë i strategjisë së Misionit për mbështetjen e përgjithshme të qëllimit të demokracisë dhe qeverisjes. Fushat e këtij përqendrimi do të kërkojnë qytetarë të informuar më mirë me një shtim të përpjestueshëm të ndikimit në

politikën publike. Ky objektivi do të kërkojë të krijohen kushtet, në të cilat qeveritë lokale të jenë më të përgjegjshme dhe transparente në veprimtarinë e tyre. Përveç kësaj, me shtimin e transferit të përgjegjësive në nivele më të ulëta, do përqendrohen aktivitetet për të ndihmuar komunitetet që të përmbushin funksionet e tyre kryesore në mënyrë më efektive.

S.O. 2.2 – Qeveria më e aftë, transparente dhe përgjegjëse që vepron sipas sundimit të ligjit do të jetë në fokus të aktivitetit të punës së Misionit për krijimin e një demokracie të qëndrueshme në Kosovë. Për të bërë këtë, Misioni do të sigurojë ndihmën që do të krijojë kushte për zgjedhje të lira, të drejta dhe më reprezentative të administratës nga vendorët. Ai do të punojë edhe në administrimin e drejtësisë, duke ndihmuar për krijimin e një kornize ligjore themelore që i mbështet institucionet demokratike, si dhe siguron burime dhe teknika që do të shpëjnë në administrim të drejtë dhe transparent të drejtësisë.

Objektivat e veçantë

Dy iniciativat të veçanta do të përfshijnë fusha të rëndësishme që bijnë jashtë strategjisë kryesore – kundërtrafikimi dhe energjia elektrike. Përpjekjet për kundërtrafimin do të vënë në shënjestër eliminimin e trafikimit dhe mbrojtjen e rehabilitimin e personave të trafikuar. Aktiviteti për energjinë elektrike do t'u ofrojë ndihmë me maturi IPVQ-së dhe të Korporatës Energjetike të Kosovës.

Objektivi i mbështetjes së programit

Programet e tërthorta do të zbatohen me objektivin e programit mbështetës. Këto aktivitete do të zgjidhin përpjekjet për krijimin e kuadrove dhe do t'i përkrahin të gjitha objektivat strategjike. Trajnimi do të përfshijë udhëheqjen e grave dhe aktivitetet e tjera të orientuara për gratë. Përmes themelimit të partneritetit të ri publik e privat, do të organizohet një iniciativë e re e shkollimit, që përbëhet nga bursat pasuniversitare dhe seminarët.

3. Rrugët që nuk merren

Për zhvillimin e fazës vijuese të ndihmës së USAID-it në Kosovë, Misioni, me një buxhet të propozuar sa gjysma e atij para tre vjetësh, është detyruar të marrë një vendim të vështirë dhe të caktojë prioritetet e veta me kujdes. Është vendosur në fillim, konfirmuar në konsultimet parastrategjike në Uashington në shtator, se Misioni ka nevojë të përqendrohet në fushat ku ai tashmë ka vendosur ekspertizën dhe të dhëna të dëshmuara të ndihmës. Prandaj, nuk do të shqyrtohen disa fusha që ishin identifikuar të jenë me prioritet të lartë në tërheqjen e strategjisë që është mbajtur në tetor të vitit 2002. Këto fusha janë ambienti, arsimiti zyrtar dhe shëndetësia.

Ambienti

USAID-i nuk ka siguruar asnjë ndihmë për sektorin e ambientit. Megjithatë, Vlerësimi mbi biodiversitetin, i kryer në prill të vitit 2003 (shih shtojcën 5.6), ka përmbajtur disa rekomandime kuptimplota dhe të dobishme për përfshirjen e masave të ambientit në programet ekzistuese dhe të planifikuara. Misioni do të shfrytëzojë këtë vlerësim për të orientuar aktivitetet tona, sidomos në fushën e agrobiznesit. Përveç kësaj, ai vlerësim do

të shfrytëzohet me donatorë dhe institucione lokale të tjera të angazhuara në çështjet e ambientit.

Arsimi

Ristrukturimi dhe zhvillimi i sektorit të arsimit zyrtar ka qenë dhe do të vijojë të jetë në përkujdesin e donatorëve të tjerë. Megjithatë, duke pasur parasysh nevojën e ngutshme për përmirësimin e niveleve të arsimit, Misioni do të mbështesë trajnimin e caktuar dhe iniciativat e arsimit me objektivin e mbështetjes së programit.

Shëndetësia

Deri tani USAID-i ka siguruar vetëm ndihmë minimale për iniciativat e caktuara të shëndetësisë, dhe madje as këto përpjekje minimale nuk mund të mbështeten me nivelin financiar të reduktuar. Nëse USAID-i/Uashingtoni është i gatshëm të financojë plotësisht ndonjë ndërhyrje në sektorin e shëndetësisë, Misioni është i përgjegjshëm t'i dalë zot një përpjekjeje të tillë.

4. Supozimet kryesore për sukses

Shumë kushte qëndrojnë përtej kontrollit të drejtpërdrejtë të USAID-it, ndonëse mbase jo jashtë ndikimit tonë. Ngecja ose dështimi në secilën nga këto fusha me siguri do të ngadalësonte hapin e reformës dhe do të ndikonte negativisht në thellësinë dhe qëndrueshmërinë e përparimit të arritur. Theksimi i të gjitha supozimeve është parashikim që statusi përfundimtar i Kosovës do të jetë vërtet një formë e “autonomisë kuptimplote”, siç deklarohet në RKS KB-në 1244, dhe se autonomia e tillë do të kërkonte zhvillimin e institucioneve, ambientin juridik dhe aftësimin njerëzor të përfshirë në programet e USAID-it. Supozimet e lidhura me objektiva specifike janë parashtruar në Pjesën II. Supozimet e përgjithshme që paraqiten në këtë strategji përfshijnë:

- Përparimi i dukshëm do të bëhet në zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës.
- Transferimi i pushtetit nga UNMIK-u tek IPVQ-ja do të vazhdojë me hapa optimalë.
- Decentralizimi nga qeveria qendrore në ato lokale do të shkojë përpara siç është planifikuar.
- Integrimi i ekonomisë së Kosovës me Evropën dhe me sistemin tregtar ndërkombëtar do të vijojë të jetë prioritet i lartë i Kosovës dhe i partnerëve ndërkombëtarë.
- Burimet e donatorëve do të zhduken me një shkallë graduale që të mos krijohet shok ekonomik, dhe kjo lejon përparim të vazhdueshëm drejt begatisë ekonomike dhe politike.
- Nuk do të paraqitet asnjë konflikt ose krizë e madhe rajonale.
- Sektori i energjisë do të furnizojë Kosovën me energji elektrike 24 orë në ditë për afat të shkurtër dhe do të fillojë të zbatojë zgjidhje afatgjata të problemeve të veta.

5. Qëndrueshmëria

Sigurimi që të bëhet përparim i qëndrueshëm në aktivitetin e ndërmarrë gjatë pesë vjetve të ardhshme është prioriteti kryesor i USAID-it/ Kosovës. Mungesa e qëndrueshmërisë në çdo aktivitet do të ndikojë negativisht në përparimin e të tjerëve. Misioni ka mendjen të punojë me partnerët dhe zbatuesit për të siguruar që ndërhyrjet të caktohen sipas mundësive të shoqërisë për t'i absorbuar dhe përdorur në mënyrë produktive.

Çështja e qëndrueshmërisë nuk është një mendje tjetër, por është e mishëruar në vetë strategjinë. Theksimi i programeve të paraqitura në këtë strategji dhe fundamentale për sukses janë dy tema themelore që do të ndiqen – ngritja e kuadrove dhe përgjegjshmëria. Këto elemente janë gurë themeli i strategjisë sonë të qëndrueshmërisë. Ngritja e kuadrit profesional i ka dy aspekte – (1) forcimin institucional/organizativ dhe (2) aftësinë e individëve për t'i udhëhequr këto organe. Kosovës i nevojiten të dyjat. Aftësia në nivelin institucional ende është në fazat e formimit; udhëheqësit, menaxherët dhe profesionistët ende nuk kanë trajnim dhe përvojë të mjaftueshme për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme. Integral i ngritjes së kuadrove është koncepti i përgjegjshmërisë – përgjegjshmëria e institucioneve të qeverisë ndaj qytetarëve, e biznesit ndaj konsumatorëve dhe e individëve ndaj të tjerëve.

Shkallëzimi

Misioni pajtohet me konkluzionet e Byrosë për Ndhimë Evropës dhe Evropës së Misioni nuk ka nevojë të parashikojë mbylljen e plotë të fazave brenda kësaj periudhe të strategjisë. Me përfundimin e ndihmës së vet prej katër vjetësh, Kosova do të jetë larg asaj që të jetë në gjendje të funksionojë pa mbështetje të dukshme të donatorëve. Një mision i paradokshëm i FMN-së në Kosovë ka ardhur në përfundim se Kosova është caktuar të mbetet e varur nga pikëpamja institucionale dhe financiare gjatë disa vjetve në të ardhmen. As baza ekonomike as ajo institucionale nuk janë aq të fuqishme sa në vendet fqinje të Ballkanit. Në konsekuencë me prioritetet e Qeverisë së SHBA-së për rajonin, programet e USAID-it janë përpiluar dhe strukturuar për të ndihmuar Kosovën të bëhet pjesë integrale e Evropës. Prandaj, shkallëzimi i ndihmës duhet të vlerësohet në bazë të aftësisë së Kosovës për t'i plotësuar kriteret e kërkuara për hyrje në Unionin Evropian. Puna e ndërmarrë brenda objektivave strategjike do të udhëhiqet sipas standardeve dhe kërkesave që nevojiten të arrihen për në atë pikë.

Ndonëse ky shkallëzim mund të jetë me vite para nesh, Misioni është fare i vetëdijshëm se programi i USAID-it për ndihmë duhet të jetë i kujdesshëm për një strategji të daljes. Për këtë qëllim, Misioni është duke zhvilluar mekanizmin e vet të parë të ligjshmërisë – një fondacion për arsim, i cili do të sigurojë trajnime për diplomë dhe studime. Ky fondacion është duke u dizajnuar si përpjekje e bashkëpunimit me sektorët privatë dhe joqeveritarë. Ai do të jetë një aleancë publike-private, e cila do të vazhdojë të sigurojë arsim cilësor për kosovarët e kualifikuar, bukur shumë përtej asaj që ka USAID-i në Kosovë.


6. Partnerët e zhvillimit

Meqë asnjë donator, përfshirë edhe USAID-in, nuk ka burime për të bërë gjithçka, koordinimi me bashkësinë e donatorëve është shumë i rëndësishëm. Në Kosovë,

koordinimi i donatorëve është posaçërisht i rëndësishëm, duke pasur parasysh rolin specifik të KB-së dhe përmasën e bashkësisë ndërkombëtare. Shumë reforma varen nga miratimi i PSSP-së dhe pushteti i katër shtyllave të UNMIK-ut. Më tutje, meqë Kosova është pjesë e Evropës dhe zbaton ligjet dhe standardet evropiane, është e rëndësishme marrëdhënia e ngushtë me partnerët evropianë. Në të gjitha fushat, siç zhvillohet aftësia, USAID-i do të avancojë transferimin e pushtetit tek IPVQ-ja. Kjo do të kërkojë punë të vrullshme me palën kosovare për të institucionalizuar dhe zbatuar plotësisht reformat që nevojiten për të mbështetur politikën e shëndoshë dhe klimën institucionale për investime.

Si për shkak të nevojës ashtu edhe të preferencës, Misioni i jep përparësi bashkëpunimit dhe e sheh veten si partner shumë bashkëpunues në Kosovë. Një prej perceptimeve të hershme për zhvillimin e këtij plani strategjik ka qenë se ai do të jetë përfshirës dhe do të ketë pjesëmarrës. Nga një tërheqje e hershme të strategjisë në tetor të vitit 2002, përmes tryezave të rrumbullakëta dhe grupeve të përqendruara në muajt që vijuan - është kërkuar në mënyrë aktive përfshirja e partnerëve tanë të zhvillimit – palët qeveritare, donatorët e tjerë, shoqëria civile, sektori privat dhe zbatuesit tanë. Përgjigjja e tyre ka qenë shpërblyese dhe e vlefshme. Pjesëmarrja e tyre nuk ka pasuar vetëm një strategji me informacion më të plotë, ajo ka hapur edhe shtigje të tjera për dialog. Ne dëshirojmë të përfitojmë nga ky çast. USAID-i është në proces të inicimit të një qasjeje më ekstenzive të ekipit të menaxhmentit. Me forcimin dhe zgjerimin e ekipeve të objektivave strategjike, Misioni mendon të ndërtojë një lidhje që e ka bërë me partnerët tanë dhe të vazhdojë t'i përfshijë në procesin e zbatimit. Suksesi i programeve tona varet nga ky bashkëpunim aktiv.

KORNIZA STRATEGJIKE



PJESA II: OBJEKTIVAT E STRATEGJISË DHE PLANET E PROGrameve

OBJEKTIVI I STRATEGJISË 1.2: KLIMË E PËRMIRËSUAR POLITIKE DHE INSTITUCIONALE PËR INVESTIME NË PRODHIM

A. DEKLARATË PËR OBJEKTIVIN E STRATEGJISË

Përqendrimi në këtë objektiv do të përmirësojë ambientin institucional, politik dhe ligjor për investime në prodhim, me përqendrimin kryesor mbi kosovarizimin – trajnimin dhe kthimin e përgjegjësive ndaj kosovarëve dhe institucioneve kosovare. Krahas punës së vazhdueshme në ndërtimin e institucioneve fiskale dhe komerciale, do të kompletohet një organ i gjithmbarshëm i legjislacionit komercial, me theks mbi trajnimin e komunitetit ligjor për t'i zbatuar ligjet në mënyrë përkatëse. USAID-i po ashtu do të avancojë privatizimin e plotë dhe integrimin e Kosovës në tregun rajonal. Me këtë objektiv synohet të krijohet një ekonomi stabile me institucione të fuqishme dhe me një ambient që inkurajon zhvillimin e sektorit privat dhe të investimeve në prodhim që janë të qëndrueshme dhe funksionojnë mirë pa mbështetjen e donatorëve.

B. ANALIZA E PROBLEMEVE

Investimi privat në Kosovë është shumë i vogël – vlerësohet të ketë qenë nën 150 milionë euro në vitin 2002. Nivelet e shtuara të investimeve private dhe sidomos të investimeve në prodhim, si nga burimet e jashtme ashtu edhe të brendshme janë qenësore për të krijuar zhvillimin ekonomik të shpejtë dhe të qëndrueshëm. Për të tërhequr investime të tilla, Kosova duhet të shikohet si vend ekonomikisht stabil dhe që e mbron biznesin e vet. Është përmbushur shumë nga ky aspekt. USAID-i ka vënë burime të dukshme në ndërtimin e rregullativës financiare dhe në institucionet fiskale dhe ka ndihmuar të zhvillohen politikat dhe legjislacioni. Ndhima më e madhe e USAID-it është siguruar për AQF-në, tani Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, dhe për Autoritetin e Bankave dhe Pagesave të Kosovës (BPK).

Këto përpjekje shikohen kryesisht si të suksesshme; mirëpo, mbetet për t'u bërë shumë punë. Ndërtimi i institucioneve të fuqishme nga “gërmadhat” po merr mbi tre vjet. Institucionet ende janë në lindje e sipër, procedurat janë të reja dhe mbetet për t'u bërë shumë për ngritjen e kuadrove. IPVQ-ja ka më pak se dy vjet që ekziston, sëkëndejmi asaj i mungon aftësia për t'i administruar funksionet e veta plotësisht dhe me efikasitet; prandaj nuk mund të tepruhet me nevojën për ngritje plotësuese të kuadrove. Më tutje, disa kompetenca thelbësore ende nuk janë transferuar tek IPVQ-ja.

Një ambient juridik që mbështet investimet dhe veprimtarinë ndërmarrëse është një prej kushteve më të rëndësishme për zhvillimin ekonomik. Ndonëse USAID-i ka mbështetur zhvillimin e legjislacionit komercial parësor, ky regjim ende nuk është i plotë. Mungesa e përhapur e mirëkuptimit dhe e pamundësisë për të zbatuar ligjet pengon qeverisjen e mirë dhe zhvillimin ekonomik. Mbetet shumë punë, përfshirë edhe legjislacionin e mbetur dhe, ajo që është e rëndësishme, trajnimin e komunitetit ligjor.

Dy fusha të tjera kanë nevojë për vëmendje të veçantë për t'u paraqitur zhvillimi i vërtetë ekonomik në Kosovë - privatizimi dhe integrimi i tregut. Ndonëse përparimi në këto fusha ka ngecur, është koha e duhur për USAID-in që t'i intensifikojë përpjekjet.

Privatizimi në Kosovë po fillon vetëm tani, me ofertat e para të nxjerra në maj të vitit 2003. Ka 478 NSh dhe NP për t'u privatizuar, me një mandat ligjor që kërkon privatizimin deri në fund të vitit 2005. Nuk do të paraqiten kurrfarë investimesh në prodhim as kurrfarë zhvillimi ekonomik derisa ky proces të jetë në rrugë e sipër. Më tutje, është e domosdoshme që buxheti qendror të pushojë me subvencionimin e këtyre NSh-ve dhe të NP-ve.

Kosova nuk është e integruar mirë në regjimet e tregut rajonal. Çështja e statusit e ka ndërlikuar përfshirjen e Kosovës në aranzhmane tregtare të lira që janë lidhur në kohë të fundit midis Serbisë dhe Malit të Zi dhe vendeve të tjera në rajon. Mandej, Kosova vazhdon të zhvillojë praktikë të tregtisë të diskriminuar nga vendet fqinje. Meqë integrimi tregtar është fundamental për zhvillimin ekonomik të Kosovës, përqendrimi kryesor i ndihmës së ardhshme do të jetë për lehtësimin e tij.

Shpejtimi i investimeve në prodhim për ta zgjeruar sektorin privat të vogël dhe në lindje e sipër do të bëhet vetëm me kushte ekonomike të volitshme. Pra, nevoja për të forcuar politikën, institucionet dhe legjislaturën mbeten prioritet. Nëse vonohet ose fundoset përparimi në këto fusha kryesore, efekti negativ mbi ambientin do të ngadalësojë zhvillimin. Për t'i ikur kësaj, USAID-i duhet të përfitojë nga çasti për krijimin e ambientit mbështetës.

C. KORNIZA E REZULTATEVE

Nuk mund të ketë investime në prodhim kur mungon ambienti makroekonomik stabil dhe ambienti i mbështetjes ligjore. Kjo kërkon që Kosova të ketë politikë fiskale të shëndoshë, të zbatuar me zotësi dhe një ambient gjithpërfshirës dhe me mbështetje fiskale dhe ligjore. Zhvillimi ekonomik i shpejtuar po ashtu kërkon përfundimin e procesit të privatizimit si dhe të integritit në tregun rajonal. Prandaj, ndihma e USAID-it do të përqendrohet në pesë fusha të radhitura më poshtë.

1. Lidhjet shkakore

RN 1.2.1 Sistemet e buxhetit dhe të taksave plotësisht të zhvilluara dhe të institucionalizuara

Për të krijuar një ambient makroekonomik stabil, ndihma do të sigurojë institucionalizimin e plotë të funksioneve fiskale të shëndosha në MFE dhe administrimin e taksave. Do të vihet theksi mbi politikën dhe analizën makroekonomike, mbi planifikimin dhe zbatimin buxhetor të përmirësuar, mbi politikën e përmirësuar të taksave dhe administrimin e taksave, si dhe mbi zhvillimin e menaxhmentit të borxheve, të njësisve të prokurimit dhe të revizionit të brendshëm. Decentralizimi fiskal, ndonëse është në rrugë e sipër, do të kërkojë shumë punë plotësuese në nivelin lokal për të siguruar që të hyrat të jenë adekuate dhe proceset e buxhetit të jenë transparente dhe efikase. Deri në fund të periudhës së strategjisë, MFE-ja do të jetë institucion i fuqishëm që i nevojitet Kosovës, duke e kërkuar pozitën e vet qendrore, e aftë të marrë udhëheqjen e planifikimit strategjik të Kosovës, dhe të ketë aftësi të shkëlqyeshme për t'i menaxhuar përgjegjësitë fiskale të qeverisë. Qeveritë komunale do të kenë mundësi të administrojnë përgjegjësinë e funksioneve fiskale.

RN 1.2.2 Sistemi i rregullativës financiare i përmirësuar

Një sektor i fuqishëm financiar dhe i rregulluar mirë është element shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik. Ndihma do të fuqizojë funksionet e mbikëqyrjes financiare të BPK-së dhe do të sigurojë që Trusti i Kursimeve të Pensioneve i Kosovës të administrojë në mënyrë përkatëse nivelin II të sistemit të pensioneve.

RN 1.2.3 Përmirësimi i politikës publike dhe i ambientit ligjor

Ndihma teknike do të mbështesë dekretimin e ligjeve komerciale. Ndërkaq shpallja e ligjeve komerciale do të përfundojë së shpejti, mbështetja ndaj ambientit ligjor do të theksojë ndihmën për zbatimin e plotë dhe efikas, si dhe vënien në jetë të legjislacionit përmes komunitetit ligjor të trajnuar më mirë dhe të mekanizmave të zbatimit. Përveç kësaj, iniciativat e USAID-it do të synojnë të rrisin cilësinë dhe nivelin e dialogut publik-privat mbi politikën ndërmjet krijuesve të politikës të Kosovës dhe udhëheqjes së sektorit të saj privat.

RN 1.2.4 Integrimi i shtuar në tregun rajonal

Ndihma për ta integruar plotësisht Kosovën në tregun rajonal do të vazhdojë përmes periudhës së strategjisë. Në këtë do të përfshihet ofrimi i ndihmës me marrëveshjet tregtare dypalëshe, sipas mundësisë duke lehtësuar përfshirjen e Kosovës në kuadër të sistemit të tregut të lirë rajonal dhe duke e harmonizuar regjimin e tregut të Kosovës me atë të pjesës tjetër të rajonit. Në të njëjtën kohë, do të intensifikohen përpjekjet për t'u siguruar që marrëveshjet ekzistuese në mes të Kosovës dhe fqinjve të saj respektohen dhe vihen në zbatim. Në këtë ndihmesë do të përfshihet edhe puna me ministritë përkatëse, për t'i ndihmuar Kosovës në përmbushjen e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare.

RN 1.2.5 Mjetet e qeverisë privatizohen ose komercializohen

Përpjekjet e USAID-it do të synojnë të përshpejtojnë privatizimin, si dhe të promovojnë procedurat që mundësojnë një proces transparent dhe konkurrues, siç është ndihmesa në tenderat garues dhe procedurat e likuidimeve të rregullta. Me paraqitjen e privatizimit, ndihmesa e USAID-it do të inkurajojë qeverisjen e mirë të përbashkët në nivel të firmës, përmes legjislacionit dhe trajnimeve.

2. Supozimet e rëndësishme

- Përpjekjet e privatizimit do të përshpejtohen
- Vonesat në procesin ligjvënës do të zgjidhen, duke përshpejtuar dekretimin e legjislacionit

D. PËRPARIMI DERI TANI

Që nga viti 1999, përparimi në ndërtimin e institucioneve, politikën e shëndoshë dhe kornizën ligjore për Kosovën nuk kanë qenë edhe i pakonsiderueshëm. Me ndihmën e USAID-it, MFE-ja është duke u forcuar si institucion, e aftë që ta kryejë me përgjegjësi rolin e vet si ministri qendrorë e financave dhe është duke zhvilluar kompetencë në të gjitha funksionet e saj. Decentralizimi fiskal është në rrugë të mbarë përmes një sistemi të financave ndërqeveritare që decentralizon tatimet, buxhetin dhe funksionet e thesarit të komunat, duke përfshirë zbatimin e plotë të tatimit mbi pronën.

Në sferën financiare USAID-i ka ndihmuar në rindërtimin e sistemit bankar të Kosovës, një sfidë madhore që ka kërkuar zhvillimin e sistemit nga poshtë lart. Një përqëndrim i

rëndësishëm ishte përkrahja për Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (BPK) në përgjegjësitë e saj rregullatore për sistemin bankar, të sigurimeve dhe të pensioneve. Ndihtesa e USAID-it ka fuqizuar edhe procedurat e kontabilitetit të BPK-së dhe ka krijuar një sistem elektronik të teknologjisë së lartë të këmbimit ndër-bankar dhe të zgjidhjeve. Aftësia mbikëqyrëse financiare e BPK-së gjërësisht vlerësohet si e suksesshme. Për shembull, kjo pasqyrohet në sektorin e shëndoshë bankar komercial që përbëhet prej shtatë bankave dhe pesëmbëdhjetë institucioneve mikro-financiare, me besim në sistemin bankar të dëshmuar me më shumë se 400 milion euro në depozita.

Njëra nga të arriturat më të rëndësishme dhe me rrjedhoja afatëgjata ka qenë themelimi i një sistemi pensional tre-nivelësh tërësisht të ri në Kosovë. Nivelin I siguron një përfitim minimal pensional të indeksuar (aktualisht 35 euro në muaj) për çdo kosovar të moshës mbi 65 vjeç. Nivelin II, që është ende duke u përpunuar, është plan i detyrueshëm vetëfinancues i definuar i kontributeve. Sipas një qasje në fazë, deri në fund të vitit 2003 nga të gjithë të punësuarit dhe të vetëpunësuarit do të kërkohej të japin kontributet e Nivelit II. Nivelin III u lejon punëdhënësve të ofrojnë plane vullnetare private të pensioneve.

Propozimet e USAID-it kanë ndihmuar në krijimin e një strategjie për ta avancuar privatizimin dhe kanë ofruar tërë shtysën e nevojshme për të mundësuar fillimin e procesit. Përveç tjerash, USAID-i ka krijuar legjislacionin që është shumë i rëndësishëm për privatizimin, duke përfshirë ligjin mbi shfrytëzimin e tokës që sqaron dhe siguron shfrytëzim të përshtatshëm të tokës dhe të drejta transferimi për investitorët.

E. QASJET NË PROGRAM

Ndihtma e USAID-it do të sëndërtohet mbi punën themelore tashmë të bërë për të siguruar që institucionet dhe reformat të jenë jetëgjata. Kështu që ndihmta do të përqendrohet në fushat ku USAID-i ka arritur suksese, duke i përfunduar elementet e mbetura, si dhe duke siguruar që politikat, ligjet dhe procedurat vërtet të zbatohen në mënyrë të qëndrueshme. Tema e përbashkët për të gjithë ndihmën nën këtë objektiv strategjik është Kosovarizimi – ndërtimi i institucioneve të qëndrueshme të plotësuara me personel të trajnuar që zbaton politika dhe procedura të shëndosha.

1. Aktivitetet ilustruese

Sistemi i buxhetit dhe i tatimit: Zhvillimi i mëtejshëm i politikave dhe procedurave të shëndosha fiskale do të kërkojë ndihmë teknike të rregullt për MFE-në. Thekset do të vihen në Kosovarizim dhe në aftësimin e kuadrove, për të fuqizuar aftësinë institucionale të MFE-së. Me përparimin e decentralizimit, USAID-i do të vazhdojë të sigurojë trajnime për qeveritë komunale mbi politikat dhe procedurat e shëndosha të të ardhurave dhe të buxhetimit.

Përmirësimi i sistemit të rregullativës financiare:

Këto funksione do të fuqizohen me anë të ndihmës teknike afatshkurtër për departamentet mbikëqyrëse në kuadër të BPK-së: të bankave, të sigurimeve dhe të pensioneve. Përveç kësaj, trajnimet thelbësore si brenda, ashtu edhe jashtë Kosovës do të aftësojnë mëtej kuadrot dhe do t'i zgjerojnë njohuritë për trajtimin e problemeve të caktuara që mund të dalin. Ajo do t'i ekspozojë kosovarët ndaj institucioneve rregullatore financiare që janë më të përparura se BPK-ja, si dhe do t'u ndihmojë të krijojnë marrëdhënie me homologët në rajon.

Ambienti politik dhe ligjor: Përderisa ndihmesa për hartimin e ligjeve komerciale të mbetura do të jetë prioritet, USAID-i do të vë theksin edhe në zbatimin dhe vënien në jetë të këtyre ligjeve. Kështu që parashihet trajnim intensiv për komunitetin ligjor, duke kërkuar bashkërendim të ngushtë me përpjekjet tjera për reforma gjyqësore dhe reforma tjera ligjore. Në nivel të politikës, USAID-i do të vazhdojë të promovojë aftësinë për dialog dinamik dhe të informuar mbi politikat publike përmes angazhimit të vazhdueshëm me grupet vendore të ekspertëve dhe duke i mbështetur ato.

Kritja e integritetit në tregun rajonal. USAID-i do ta mbështesë Ministrinë e Tregëtisë dhe Industrisë në hartimin dhe zhvillimin e marrëveshjeve tregtare rajonale, duke futur në përdorim shfrytëzimin e kodeve të prodhimeve, si dhe të ligjeve dhe rregulloreve që janë në përputhje me Organizatën Botërore të Tregëtisë. Ndhimë do të ofrohet edhe për themelimin e një agjencie për të monitoruar përputhjen me ligjet dhe marrëveshjet tregëtare.

Privatizimi ose komercializimi i mjeteve të qeverisë. Krahas sigurimit të proceseve transparente dhe konkurrese për transaksionet e privatizimit, USAID-i do të ndjek dekretimin e ligjit mbi kompanitë me dispozitat për qeverisjen e përbashkët që do të rregullojnë pronarët dhe menaxherët e rinj të subjekteve afariste.

2. Lidhjet

Faktorët e tërthortë: Në ndihmesën e USAID-it do të vazhdohet të përfshihen masat parandaluese dhe ato zbatuese, për ta mbajtur korrupsionin larg nga infiltrimi në institucione. Në këto masa do të hyjnë: krijimi i procedurave transparente, i ligjeve dhe proceseve të prokurimit, i njësive të revizionit të brendshëm, kodeve të etikës, si dhe i dispozitave për sanksionet dhe masat detyruese kur ndodhin shkelje. Edhe aftësimi i kuadrove do të jetë pjesë përbërëse e të gjitha aspekteve të OS-së. Me rritjen e investimeve në prodhim, do të rriten mundësitë për punësim të popullatës së re. Të gjitha programet e ndërtimit të institucioneve dhe të trajnimit do ta promovojnë barazinë gjinore.

Objektivat e tërësishëm strategjik: Ky objektivi është i lidhur ngushtë me OS 1.3 për përsheptimin e rritjes së sektorit privat, duke përfshirë lidhjet e qarta në zhvillimin e legjislacionit komercial, si dhe të punës me sektorin privat në integrimin e tregut. Aktivitetet e decentralizimit fiskal nën këtë objektivi do të bashkërendohen ngushtë me aktivitetet e Qeverisjes Lokale sipas OS 2.1. Trajnimi mbi ligjin komercial për komunitetin ligjor do të realizohet përmes ndihmës ndaj gjyqësorit sipas OS 2.2.

F. QËNDRUESHMËRIA

Të gjitha fushat e ndihmës duhet të jenë të zhvilluara mirë deri në fund të strategjisë pesëvjeçare, duke i mundësuar USAID-it fazën e daljes nga këtu gjatë periudhës së strategjisë, dhe të përqëndrohet në përkrahjen e pikësnyuar diskrete. MFE-ja do të jetë një institucion i fortë dhe i aftë për t'i realizuar funksionet e veta me përgjegjësi. Tashmë BPK-së, që gjërisht konsiderohet si e suksesshme, do t'i sigurohet vetëm ndihmë specifike gjatë dy viteve të para të kësaj periudhe të strategjisë. Pas dy viteve shtesë të ndihmës, Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës do të jetë në gjendje të administrojë me efikasitet Nivelin II të sistemit pensional. Korniza e ligjit komercial duhet të përfundohet brenda 18 muajve të parë, duke mundësuar kah fundi i periudhës së

strategjisë, kapacitet për komunitetin ligjor për ta vënë në jetë si duhet legjislacionin. Po ashtu duhet të përfundohen privatizimi dhe ndihma përkitazi me integrimin rajonal të tregut.

USAID/ZHVILLIMI EKONOMIK I KOSOVËS OS 1.2

USAID/Qëllimi i Programit Ekonomik të Kosovës: Për ta stimuluar rritjen ekonomike me anë të promovimit të integritimit të ekonomisë në rajon dhe duke stimuluar investimet në prodhim në Kosovë, prej nga në Kosovë do të prodhoheshin mallra dhe ofroheshin shërbime me vlera shtesë për konsum të brendshëm dhe të jashtëm, duke krijuar kështu mundësi të reja të qëndrueshme për punësim.

OS 1.2: Përmirësimi i klimës politike dhe institucionale për investimet në prodhim

Treguesi: Investimet private ngriten për 20% në vit
Afati kohor: 2004-2008

RN 1.2.1: Buxheti dhe sistemet e tatimeve plotësisht të hartuar dhe të institucionalizuar	RN 1.2.2: Përmirësimi i sistemit rregullator të financave	RN 1.2.3: Përmirësimi i politikës publike dhe ambienti ligjor	RN 1.2.4: Rritja e integritimit në tregun rajonal	RN 1.2.5: Privatizimi i tërësishëm i mjeteve të qeverisë
<p>Treguesit: Tatimet: Përparimi kundrejt standardeve të tatimeve</p> <p>Buxheti: Përparimi kundrejt standardeve të buxhetit</p> <p>Rritja e të ardhurave prej tatimeve nga prona e komunës</p>	<p>Treguesi: Rritja e depozitave bankare</p>	<p>Treguesi: Ligjet e pikësnyuara komerciale dekretohen</p> <p>Përparimi kundrejt standardeve ligjvënëse</p>	<p>Treguesi: Rritja e eksporteve</p>	<p>Treguesi: Organizatat në pronësi shoqërore dhe ato në pronësi private, privatizohen, komercializohen ose likuidohen.</p>
<p>Afati kohor: 2004- 2008</p> <p>Partnerët zhvillimorë: BE, FMN, BB, AER, SIGMA (OECD), Ministria e Financave dhe Ekonomisë</p>	<p>Afati kohor: 2004-2005</p> <p>Partnerët zhvillimorë: FMN, BE, UNMIK, Ministria e Financave dhe Ekonomisë</p>	<p>Afati kohor: 2004-2008</p> <p>Partnerët hvillimorë: AER, RIINVEST, Zyra e çështjeve ligjore e UNMIK-ut, Zyra e Kryeministrit, Departamenti i Çështjeve Gjyqësore</p>	<p>Afati kohor: 2004-2008</p> <p>Partnerët hvillimorë: AER, Shoqata e Eksportuesve të Kosovës, Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë</p>	<p>Afati kohor: 2004-2005</p> <p>Partnerët zhvillimorë: BE, AER, AKM/UNMIK, Sindikata e Kosovës, Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë, Oda e Posaçme e Gjykatës Supreme</p>

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1.3: RITJIA E PËRSHPEJTUAR E SEKTORIT PRIVAT**A. DEKLARATA E OBJEKTIVIT STRATEGJIK**

Në përshpejtimin e rritjes së sektorit privat, ky objektivi do ta mbështesë zhvillimin dhe zgjerimin e industrive konkurruese, do të promovojë rritje në tregun vendor dhe rajonal të këmbimeve, dhe do të krijojë opcione për ndarje të mjeteve të kapitalit të udhëhequra nga tregu. Ky objektivi do të realizohet drejtpërdrejt me ndërmarrjet dhe shoqatat e tregëtisë, për të përmirësuar konkurrencën e ndërmarrjeve dhe të industrive të Kosovës. Ajo në mënyrë specifike do të përqëndrohet në agrobiznes për t'i përmirësuar standardet dhe proceset për të përmbushur kërkesën vendore. Kjo do të ndihmojë në rritjen e eksportit në industritë e përzgjedhura që kanë demonstruar potencial për të konkuruar në aspektin rajonal. Ky OS do t'u ndihmojë edhe pjesëtarëve të komunitetit të biznesit në bërjen e tyre avokatë efektivë për krijimin e ambientit pozitiv dhe rregullues për biznes.

B. ANALIZA E PROBLEMIT

Përderisa përparimi i përgjithshëm në zhvillimin e ekonomisë së tregut ka qenë i konsiderueshëm, sektori privat ende nuk është dinamik ose konkurrues. Në këtë aspekt ka nevojë të madhe që t'i ndihmohet Kosovës për zhvillimin e industrive konkurruese që prodhojnë mallra të tregtueshëm si në vend, ashtu edhe në rajon. Mirëpo ndërtimi i këtyre industrive konkurruese do të ballafaqohet me shumë sfida.

Ndërmarrjet bujqësore vendore dhe përpunuese nuk kanë arritur standarde të prodhimit ose të industrisë që janë të pranueshme për eksport, ose për zëvendësimin e vëllimit të konsiderueshëm të importit me mallrat e tyre. Mungesa e njohurive dhe e teknologjisë së përparuar, e pajisur me kredi të pamjaftueshme për mjetet e kapitalit, i kontribuon kësaj mungese të konkurrencës.

Ka mungesë të gjërë të aftësive qenësore për biznes, siç është aftësia për të bërë planifikim strategjik dhe analiza financiare. Ngjashëm, ka pak aftësi për menaxhment organizativ dhe operativ. Këto aftësi janë jashtëzakonisht të pakta, për shkak se shumica e kosovarëve ishin gjërësisht të privuar nga trajnimet formale për biznes dhe nga mundësitë për shkollim gjatë tërë dekadës së fundit. Për arsye se investimet e shkallës së lartë dhe ato të sofistikuar kërkojnë menaxherë të aftë, ekziston nevoja e menjëhershme për të krijuar një klasë profesionale dhe menaxhuese.

Shoqatat efektive dhe profesionale të tregtisë ende janë në fillimet e tyre dhe ende nuk janë avokatë të fortë të sektorit privat. Organizatat për avokim, organizatat vetërregulluese dhe organizatat tjera profesionale duhet të zhvillohen mëtej për të inkurajuar dhe fuqizuar dialogun publik-privat dhe debatet mbi politikën, me qëllim të promovimit të një ambienti përkrahës dhe mundësues për investime. Tani për tani, shoqatave të biznesit u mungon aftësia për të ndikuar aktivisht dhe pozitivisht në ambientin e biznesit.

Qasja në kredi është e kufizuar, shpesh për shkak të nivelit të lartë të perceptuar të rrezikut në treg dhe kërkesave të larta shtesë për kredi afatshkurtëra për të financuar, blerjen e inventarit dhe të lëndës së parë. Përveç tjerash, megjithëse bankat janë likuide, financimi afatgjatë për mjetet kapitale pothuajse nuk ekziston. Kjo është rezultat e faktorëve të tillë si historia e shkurtër e kreditimit, sundimi i dobët i ligjit, aranzhimet joformale të punësimit dhe mungesa e përvojës në mesin e bankave sa i përket

grumbullimit të letrave me vlerë që garantojnë huatë. Kjo rëndohet nga paaftësia e shumicës së ndërmarrjeve që në mënyrë të pavarur të përgatisin plane koherente të biznesit, hulumtime të tregut, parashikime financiare dhe analiza të tjera që kërkohen nga huadhënësit e mundshëm.

Qasja në informacionin aktual të tregut, të trendeve në industri, mbi rrjetet e blerësve dhe furnizuesve dhe standardet e pranuar janë jetike për krijimin dhe menaxhimin e bizneseve konkurruese. Mirëpo, menaxherët dhe ndërmarrësit kosovarë shpesh nuk kanë qasje në informacionin në dispozicion ose në aftësitë e nevojshme për të bërë hulumtime të aplikueshme drejtpërdrejt për bizneset e tyre. Kjo është pjesërisht rezultat i pengesave gjuhësore dhe përdorimit të ulët të internetit, si dhe mungesës së trajnimit në hulumtimet e tregut.

Iniciativat e paramenduara për të rritur konkurrencën në industrinë e agrobiznesit duhet t'i trajtojnë disa nevoja të mëdha dhe të lehtësojnë jo vetëm rritjen e prodhimit, por po ashtu të ngrisin cilësinë e prodhimeve, të bëjnë përmirësimin e përpunimit, shfrytëzimin efikas të mjeteve dhe të zgjerojnë mundësitë e tregut. Përfitimet në efikasitetin në bujqësi do të çojnë në rritjen e zëvendësimit të importit dhe krijojnë një presion të brendshëm për përmirësime në regjimin e tregut për t'i gjurmuar mundësitë e eksportit. Përmirësimet e rëndësishme në efikasitetin e bujqësisë do të kërkojnë po ashtu edhe struktura kreditimi më të përshtatshme.

C. KORNIZA E REZULTATEVE

Për të pasur ekonomi të qëndrueshme, Kosova duhet të jetë në gjendje të konkurojë si në vend, ashtu edhe në rajon për t'i zvogëluar importet dhe për t'i rritur eksportet. Për të qenë konkurruese, ndërmarrjet private duhet të kenë aftësi që të përmbushin kërkesën e vendit dhe atë rajonale për mallra dhe shërbime në standardet e kërkuara nga popullata vendore dhe blerësit rajonalë. Meqë me bujqësi mbahen një pjesë e rëndësishme e popullatës, ka nevoja të posaçme që lidhen me prodhimin, për këtë arsye sektori bujqësor kërkon ndihmë të përqëndruar qartë.

1. Lidhjet shkakore

RN 1.3.1: Rritja e konkurrencës së sektorit të bujqësisë

Ky RN do të trajtojë në mënyrë specifike nivelin e ulët të prodhimit bujqësor në Kosovë, cilësinë dhe standardet e trajtimit që pengojnë shitjen e prodhimeve. Në nivel industrial, përpjekjet do të përqëndrohen në krijimin e efikasitetit në zinxhirin e prodhimit dhe në promovimin e bashkëpunimit në mesin e prodhuesve, përpunuesve, shpërndarësve, veterinarëve, importuesve, eksportuesve dhe rregulluesve për ta përmirësuar cilësinë e prodhimit, përderisa këtu përfshihen edhe shpenzimet. Ky RN po ashtu do të ndihmojë në zhvillimin e strukturave të reja të financimit për bujqësinë, të nevojshme për përshpejtimin e futjes në përdorim të teknologjive kapitale intensive të prodhimit.

RN 1.3.2: Përmirësimi i kapacitetit të ndërmarrjeve private

Ky RN do të përqëndrohet në nevojën e menjëhershme për të rritur kapacitetin e ndërmarrjeve vendore, për të përpunuar dhe prodhuar prodhime që mund të kënaqin tregjet vendore dhe të huaja në baza të qëndrueshme. Në këtë përfshihet zhvillimi i shkathtësive të tilla të biznesit si: planifikimi strategjik, zotësia menaxhuese dhe qasja në

informacionin e tregut. Krijimi i prodhimit vendor do të varet edhe nga miratimi dhe zbatimi i standardeve ndërkombëtare të industrisë dhe kontrollet e cilësisë, ashtu që prodhimet kosovare të pranohen në tregjet e huaja dhe në ato të vendit.

RN 1.3.3: Përmirësimi i kushteve në të cilat operon biznesi

Ky RN do ta inkurajojë sektorin privat që të punojë me autoritetet qeveritare për të krijuar ambient të favorshëm të biznesit në Kosovë. Duke punuar kolektivisht, me zyrtarët publikë, subjektet afariste dhe shoqatat, do të llojnë për ligje dhe rregullore të përshtatshme, do të kërkojnë qartësi në gjuhën ligjvënëse ekzistuese dhe do të sigurojnë që ligjet të kenë kuptim si për bizneset, ashtu edhe për shoqërinë.

Kjo RN po ashtu do të përmirësojë qasjen në financat private duke ndihmuar krijimin e një agjencie informative për kredi, dhe duke ndihmuar që bizneset fitimprurëse përmes planeve dhe pasqyrave financiare të demostrojnë se për to ia vlen të jepet kredi.

2. Supozimet e rëndësishme

- IPVQ-të do të vazhdojnë të përkrahin dhe të lëvizin drejt integritit në tregun rajonal dhe ndërkombëtar
- Partnerët e mundshëm tregtar negociojnë dhe vëjnë në jetë marrëveshjet tregëtare me Kosovën

D. PËRPARIMI DERI TANI

Ndihma teknike e USAID-it dhe trajnimi për NVM-të me potencial të lartë, për menaxhment, planifikim strategjik të biznesit, marketing dhe kontabilitet financiar kanë rezultuar në përmirësimin e kryerjes së detyrave dhe në fitimprurjen e shumë kompanive kosovare. Më shumë se 100 kompani kliente i kanë dyfishuar shitjet dhe fitimet e tyre.

Përpjekjet për të promovuar përfshirjen e Kosovës në sistemin rajonal të tregtisë ka sjellur më shumë se 8 milion \$ në lidhjet tregtare përmes një sërë tavolinash të rrumbullakëta për biznesin, dhe përmes panairëve të tregut rajonal. Disa nga këto ngjarje promovuese të tregut dhe të investimeve kanë bashkuar grupet ndër-etnike, si rezultat i të cilave janë rivënë lidhjet e vjetra të biznesit dhe janë krijuar ato të reja. Mëtej, Shoqata e Eksportuesve të Kosovës (ShEK) ka realizuar disa “prova eksporti” duke dërguar mallra përtej kufijve, për të demonstruar pengesat jo-tarifore ndaj tregut. Këto “prova eksporti” kanë nënvizuar dhe dokumentuar shpërdorimet nga zyrtarët e doganave në vendet fqinje, duke pasur si rrjedhojë zvogëlimin e disa prej këtyre pengesave.

Duke njohur dhe pranuar që bizneset duhet të fillojnë t’i përdorin standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, USAID-i ka themeluar Shoqatën e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Çertifikuar të Kosovës (SHKAÇK), dhe ka zbatuar një program të gjithanshëm e të përputhshëm trajnimi mbi kontabilitetin/revizionin mbi Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK). Kjo shoqatë e pavarur, edhe pse në krijim është duke punuar drejt zhvillimit të një profesioni modern të kontabilitetit në Kosovë.

Kohëve të fundit, USAID-i është duke e përqëndruar ndihmën e vet teknike në sektorët e pikësnyar, si në agrobiznes, dhe në jo-agrobiznes, duke punuar njëkohësisht në nivel të ndërmarrjes dhe të industrisë, për të arritur konkurrencën në tregjet vendore dhe rajonale. USAID-i është duke u përqëndruar në tetë industri, duke punuar me grumbuj për të

përmirësuar cilësinë e prodhimit, si për qëllime të zëvendësimit të importit, ashtu edhe për zgjerimin e eksporteve. Përdorimi i modelit në bazë të grumbujve ka mundësuar ofrim konsekuent të inputeve të cilësisë së lartë te përpunuesit.

Në agrobiznes, USAID-i ka ndihmuar në themelimin e Aleancës Kosovare të Agrobizneseve (AKA) që përbëhet prej pesë shoqatave që mbulojnë pjesën më të madhe të tregtarëve të inputeve bujqësore, të prodhuesve dhe të përpunuesve në Kosovë. Në ndihmë përfshihet trajnimi, zhvillimi, menaxhimi shoqatës dhe mbështetja për krijimin e një agjende për politikë avokimi për agrobiznesin. Analizat që i janë siguruar qeverisë nga AKA-ja, kanë rezultuar në zvogëlimin e çrregullimeve të tarifave që prekin sektorin e bujqësisë.

USAID-i ka pasur sukses të madh në rritjen e qasjes në kredi të sektorit privat. Tani ndërmarrjet e vogla kanë në dispozicion financim përmes FINCA/Kosovë, një organizatë që vetëmbahet e që ka filluar me ndihmën e USAID-it. Qasja në financim për NVM-të është rritur në mënyrë të konsiderueshme përmes themelimit dhe shfrytëzimit të Bankës Amerikane të Kosovës. Kohëve të fundit kjo bankë i është shitur Bankës Raiffeisen të Austrisë vetëm pas tetëmbëdhjetë muajve të punës së suksesshme.

E. QASJET NË PROGRAM

Gjatë periudhës së strategjisë, ndihma e USAID-it do ta përcjellë mëtej përparimin e gjerëtnishëm në fushën e përmirësimit të biznesit dhe realizimit në bujqësi. Duke u përqëndruar në krijimin e sektorëve konkures të industrisë dhe të prodhimit bujqësor, ndërkaq duke i kombinuar këto përpjekje me iniciativat për ta racionalizuar ambientin e gjithëmbarshëm të biznesit, ky objektiv strategjik do të ofrojë një qasje të integruar dhe të përqëndruar, për të zgjeruar pjesëmarrjen e sektorit privat në ekonominë e Kosovës dhe të kontribuimit për të.

1. Aktivitetet ilustruese

Ndihma në nivel të ndërmarrjes dhe të prodhimit: Përpjekjet e programit do të përqëndrohen në fuqizimin e aftësive të sektorit privat për biznes dhe financa, si në nivel të ndërmarrjes, ashtu edhe të fermës, për të arritur konkurrencën në vend dhe në rajon. Projektet e USAID-it do të vënë theksin në përmirësimin e cilësisë së mallrave, si dhe në efikasitetin në prodhim dhe shpërndarje. USAID-i do të punojë me ndërmarrjet në sektorët me potencial të lartë për të konkuruar në vend dhe rajon, përfshirë këtu agrobiznesin. Do të bëhen përpjekje në nivel të industrisë, për të ndihmuar në efikasitetin midis vepruesve të integruar në kuadër të prodhimit, shpërndarjes dhe sistemeve të rregullimit. Këto efikasitete mund të jenë të bazuara në teknologji, kapital, arsim ose ato që bazohen në informacion.

Ambienti operativ: Ndihma do të theksojë përmirësimet në ambientin e biznesit përmes avokimit nga shoqatat e forta tregëtare. Këto aktivitete po ashtu do të rrisin qasjen në kredi duke përmirësuar dhe zgjeruar ambientin e tashëm informativ për kredi dhe duke përmirësuar aftësinë e ndërmarrjeve për të përgatitur plane strategjike të biznesit dhe pasqyra financiare në bazë të standardeve ndërkombëtare. Ajo do t'i zgjerojë mekanizmat e kredive, sidomos për sektorin e bujqësisë.

2. Lidhjet


Faktorët e tërthortë: Ky OS do të trajtojë temën e tërthortë të korrupsionit përmes krijimit të një ambienti më të favorshëm pune për biznesin, që do të përfshijë një sistem më transparent dhe më të hapur të ligjeve dhe të vënies në zbatim të tyre, duke i zvogëluar mundësitë për korrupsion. Përveç kësaj, rritja në sektorin privat do të ketë efekt në papunësi dhe në shkallën e ulët të punësimit, duke i zvogëluar këto shifra, së paku në masë të parëndësishme, në afat të shkurtër. Duke ngritur në një shkallë më të lartë të mundësitë për punësim, ky OS do ta zbusë konfliktin e mundshëm duke zvogëluar tensionet ekonomike dhe sociale. Riintegrimi i mëtejshëm do të mbështetet nga lidhjet rajonale të bizneseve. Në këto do të hyjnë tryezat e rumbullakëta për biznesin dhe panairët e tregut që i bashkojnë afaristët nga etnitë e ndryshme. Kjo do të kontribuojë në rritjen e përqendrimit, më shumë në gjërat e përbashkëta midis këtyre grupeve etnike se sa në dallimet e tyre.

Objektivat e tërësishëm strategjikë: Ky objektiv strategjik përkon me OS 2.1 duke e mbështetur dhe çuar mëtej krijimin e institucioneve të shoqërisë civile në Kosovë dhe duke u përqëndruar në përmirësimin e shoqatave të biznesit si lehtësues të përmirësimeve pozitive në ambientin e biznesit. Me anë të këtij objektiv do të ngritet në shkallë më të lartë zhvillimi ekonomik lokal, duke ndihmuar në përpjekjet për të përmirësuar aftësitë e komunave për të funksionuar me efikasitet. Puna sipas këtij objektiv ka lidhje të forta me OS 1.2, që do të punojë për ambientin e biznesit nga perspektiva e qeverisë, ndërkaq ky OS do të punojë në ambientin e biznesit nga perspektiva e sektorit privat. Ky fuqizim do të ketë si rrjedhojë si të kuptuarit më të mirë të gjithëmbarshtëm të llojeve të politikave, ashtu edhe të ligjeve të nevojshme për një sektor privat konkurrues.

F. QËNDRUESHMËRIA

Ekzistojnë probleme themelore në sektorin privat që i parandalojnë ndërmarrjet nga të qenit konkurruese, qoftë në tregjet vendore ose ato rajonale. Ndërtimi i kapaciteteve themelore të bizneseve për të operuar në një ambient tregu është parakusht që mund dhe duhet të trajtohet në afat të shkurtër. Mëtej, funksionueshmëria e sektorit privat si motor i rritjes ekonomike të Kosovës varet nga faktorë të llojllojshëm, duke përfshirë përfundimin e privatizimit, zbatimin efikas të ligjeve kryesore që ende duhet të miratohen, si dhe nga sqarimi i statusit përfundimtar të Kosovës. Përparim thelbësor duhet të bëhet në këto fusha brenda dy viteve të para të strategjisë. Në këtë pikë, Misioni do të kryejë një vlerësim të ambientit të zhvillimit ekonomik dhe të biznesit në Kosovë. Puna nën këtë OS do të vlerësohet në frymën e konkluzioneve dhe nëse është e nevojshme, Misioni do të parashtrijë një amendament ndaj këtij objektiv strategjik. Përderisa objektiv, Rritja e Përsheptuar e Sektorit Privat nuk do të ndryshojë, qasja ndaj zbatimit mund të përlijë rezultatet e reja të menjëhershme.

USAID/ZHVILLIMI EKONOMIK I KOSOVËS OS 1.3



OBJEKTIVI STRATEGJIK 2.1: SHOQËRIA CIVILE DHE QEVERIA JANË PARTNERË MË EFIKAS PËR TË ARRITUR QEVERISJE TË MIRË**A. DEKLARATA E OBJEKTIVIT STRATEGJIK**

Ndihma nën këtë objektiv strategjik synon të zhvillojë dhe forcojë marrëdhënien në mes të shoqërisë civile dhe qeverive lokale, ashtu që ato të veprojnë si partnerë në çuarjen mëtej të proceseve demokratike. USAID-i do të punojë si me qytetarët, ashtu edhe me qeveritë lokale për ta zhvilluar këtë marrëdhënie. Në nivel të qytetarit, ekziston nevoja për të përmirësuar informimin publik mbi të drejtat dhe përgjegjësitë individuale, për të lehtësuar të kuptuarit e reformave politike, ekonomike dhe shoqërore, si dhe për të promovuar pjesëmarrjen qytetare. Në këto përpjekje do të përfshihen puna me media, OJQ-të dhe grupet joformale të qytetarëve. Ndihma ndaj qeverive lokale do të sigurojë që ato janë duke i përmbushur funksionet e tyre kyçe me efikasitet dhe se veprimtaritë e qeverisë lokale janë transparente dhe përgjegjëse ndaj zgjedhësve të tyre.

B. ANALIZA E PROBLEMIT

Pasiqë UNMIK-u gjithnjë e më shumë po u kalon kompetencat IPVQ-ve, dhe në veçanti qeverive komunale, qytetarët kosovarë dhe zyrtarët, në mënyrë të ngjashme janë duke luftuar për t'i kuptuar rolet, të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre. Ligjet dhe rregulloret e mjegulluara të paplota dhe kontradiktore do të thonë se qeverive komunale u mungon autoriteti i qartë për të realizuar shumë funksione themelore të qeverisjes. Kjo e pengon efektshmërinë potenciale të qeverive komunale, shkakton konflikt të panevojshëm me UNMIK-un dhe autoritetet e nivelit qendror dhe i kontribuon cinizmit publik rreth vlerave të qeverisjes lokale.

Shumica e kosovarëve nuk janë plotësisht të vetëdijshëm për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në një sistem demokratik dhe janë të hutuar në pritjet e tyre nga qeveria. Qytetarët nuk kanë informacion dhe aftësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në krijimin e politikave dhe mbikëqyrjen publike të nevojshme, për ta tejkaluar trashëgiminë e një sistemi joefikas dhe shtypës të qeverisjes. Shumicës së organizatave të shoqërisë civile ende u mungon ekspertiza dhe shkathtësitë e nevojshme për t'i paraqitur pikëpamjet e qytetarëve dhe që në mënyrë të suksesshme të avokojnë në emër të tyre. Ende është e dobët aftësia e organizatave të shoqërisë civile dhe e mediave që me efektivitet të përmbushin rolin e kujdestarit kundrejt qeverisë.

Spektori i mediave të Kosovës është i zhvilluar relativisht mirë, sidomos kur kemi parasysh shkallën deri në të cilën mediat e pavarura dhe infrastruktura e mediave ka pësuar gjatë dhe para konfliktit. Megjithatë, profesionistëve të mediave u mungojnë shkathtësitë në fushat kyçe, korniza ligjore dhe rregullatore për mediat është e paplotë, ndërkaq institucionet mbështetëse siç janë shoqatat e gazetarëve dhe Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) janë të reja ose ende të paformuara. Vonesat në miratimin e ligjeve kryesore dhe të direktivave administrative, siç janë ato përkitazi me KPM-në ose tarifat e transmetimit publik, kërcënojnë qëndrueshmërinë financiare të stacioneve televizive dhe ngadalësojnë zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të mediave. Shumë media, sidomos ato në nivelin lokal, vazhdojnë të shfaqin nivele të ulëta të profesionalizmit, i injorojnë rregullat e të drejtës së autorit, japin lajme të pabazuara dhe për krahe mbështeten vetëm në qeveritë komunale ose në partitë politike. Ka njëfarë gazetarie hulumtuese, por efekti i saj ka qenë simbolik për shkak të mungesës së shkathtësive dhe përvojës, mjeteve

të kufizuara dhe ligjeve të pamjaftueshme për t'u lejuar qasje në informacion publik dhe për t'i mbrojtur gazetarët dhe burimet e tyre.

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45 ka vendosur kornizën bazë për vetëqeverisje në nivelin komunal, por ligjet dhe rregulloret e reja janë të nevojshme për të përcaktuar procedurat dhe për t'i sqaruar kompetencat. Zyrtarëve komunalë u mungojnë aftësitë bazë, përvoja dhe mjetet për t'i realizuar detyrat e tyre, dhe për t'u ballafaquar me një varg problemesh, shumica e të cilëve janë jashtë autoritetit të tyre për t'i trajtuar. Papunësia, ndërtimet e paligjshme, ofrimi i dobët i shërbimeve publike, migrimi urban, zhvillimi i pakontrolluar urban, investimet e ulëta ekonomike, dhe çështjet etnike janë vetëm disa nga problemet shkurajuese me të cilat ballafaqohen qeveritë komunale. Që e komplikojnë situatën janë debatet në kuadër të IPVQ-ve dhe ndërmjet tyre dhe UNMIK-ut për ndërrimet e mëdha të mundshme në sistemin e tanishëm të qeverisjes lokale, duke përfshirë planet për “decentralizim” që kanë shtrirje në përbërjen etnike të njësive të qeverisjes lokale. Qeveritë komunale kanë treguar hapje të dukshme ndaj koncepteve të pjesëmarrjes publike, por nepotizmi, korrupcioni dhe mekanizmat joadekuat të mbikëqyrjes e minojnë zhvillimin e praktikave të qeverisjes së mirë.

C. KORNIZA E REZULTATEVE

Me vazhdimin e bartjes së kompetencave më të mëdha nga UNMIK-u te IPVQ-të, duke përfshirë qeveritë komunale, po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm përmirësimi i efikasitetit të shoqërisë civile dhe qeverive lokale në arritjen e qeverisjes së mirë. Shumica e problemeve të rëndësishme me të cilat ballafaqohet Kosova në afat të shkurtër duhet të trajtohen, së paku pjesërisht, në nivelin lokal. Përveç nëse bëhet përparim thelbësor, për të promovuar qeverisje të mirë lokale, ekziston rreziku i besueshëm që praktikatat e korruptuara dhe joefikase do të rrenjosen, qytetarët do ta humbin besimin në demokracinë pjesëmarrëse dhe një radhë problemesh që e kërcënojnë stabilitetin e Kosovës nuk do të trajtohen si duhet. Qytetarët kanë nevojë për qasje në informacion të qartë dhe të saktë, si dhe të kenë hapësirë të përshtatshme për të ndërvepruar me qeverinë lokale dhe për të siguruar mbikëqyrje. Qeveritë lokale kanë nevojë të bëhen më transparente dhe më të përgjegjshme, ndërkaq zyrtarët kanë nevojë për shkathtësi dhe aftësi për t'i kryer punët e tyre si duhet. Jo vetëm që zyrtarët komunalë dhe qytetarët e njohin nevojën për ndihmë të donatorëve për të përmirësuar qeverisjen e mirë lokale, por ata janë të etshëm të pranojnë këshilla dhe t'i bëjnë ndërrimet e nevojshme për ta realizuar atë. Aspekti kohor dhe konteksti për mbështetje të donatorëve në ndërhyrjet për të promovuar partneritete për qeverisje të mirë në Kosovë, për momentin janë të papërsëritshme për nga pozita e favorshme.

1. Lidhjet shkakore

RN 2.1.1: Informimi më i mirë i qytetarëve

Pjesëmarrja efikase e qytetarëve dhe ndërveprimi me qeverinë kërkojnë që qytetarët të jenë të informuar në mënyrë të mjaftueshme mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, dhe të jenë të vetëdijshëm për reformat e rëndësishme politike, ekonomike dhe sociale. Mirëpo sot niveli i vetëdijes qytetare në Kosovë është mjaft i ulët. Ka më shumë gjasa që qytetarët e informuar më mirë të inkuadrohen në procesin politik, t'i kuptojnë dhe mbështesin reformat dhe politikat kryesore dhe të kërkojnë përgjegjësi nga qeveria.

RN 2.1.2: Rritja e ndikimit të qytetarit në politikat publike

Meqë kosovarët po ndërtojnë institucione të reja të vetëqeverisjes, ndikimi i qytetarëve në politikat publike do të ndihmojë për të siguruar që sistemet e reja të jenë në mënyrë të mjaftueshme transparente dhe të përgjegjshme, dhe se prioritetet e politikave të pasqyrojnë interesat e më shumë se vetëm elitës politike. Duke pasur parasysh mungesën e ekspertizës dhe aftësive në kuadër të qeverisë, kontributi i shoqërisë civile do të kontribojë në zhvillimin e proceseve më të informuara dhe të krijimit të politikës më përfaqësuese.

RN 2.1.3: Qeveri lokale më të përgjegjshme dhe transparente

Kosovës i mungon përvoja në praktikën demokratike, koncepti i shërbimit publik është i dobët, nepotizmi praktikohet gjërësisht, korrupcioni minon zhvillimin politik dhe ekonomik, mekanizmat e mbikëqyrjes janë joadekuatë, ndërkaq ekziston mundësia për një rritje të madhe të praktikave korruptuese. Prandaj përmirësimi i përgjegjshmërisë dhe transparencës është qenësor për arritjen e qeverisjes së mirë, sidomos në nivelin lokal.

RN 2.1.4: Komunitetet përmbushin funksionet kryesore më me efikasitet

Qeveritë lokale janë gjithnjë e më të përgjegjshme për trajtimin e problemeve të ngutshme të Kosovës duke përfshirë zhvillimin ekonomik, ofrimin e shërbimeve, riparimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës, shërbimet sociale dhe përkujdesjen shëndetësore. Mirëpo ata janë thellë të papregatitur për t'i trajtuar si duhet këto çështje, për shkak të çështjeve të pazgjidhura ligjore dhe rregullatore, shkathtësive dhe mjeteve të pamjaftueshme, mungesës së përvojës. Përmirësimi i aftësive të qeverive komunale për të përmbushur funksionet kryesore me efikasitet do të ndihmojë në trajtimin e shumë problemeve që vazhdojnë ta kërcënojnë stabilitetin politik dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.

2. Supozime të rëndësishme

- Nuk do të ketë kthim prapa në bartjen e autoritetit të IPVQ-të dhe qeveritë komunale
- Miratimi me kohë i elementëve kryesorë të kornizës ligjore dhe të rregullativës do të ndodhë.

D. PËRPARIMI DERI TANI

Programet e USAID-it kanë kontribuar për një përparim të konsiderueshëm në zhvillimin e shoqërisë civile, pjesëmarrjes qytetare, mediave të pavarura dhe përgjegjshmërisë së qeverisë. Organizatat e shoqërisë civile dhe grupet joformale të qytetarëve kanë luajtur një rol të rëndësishëm në rindërtimin pas konfliktit, dhe po fillojnë të marrin përsipër iniciativat më të ndërlikuara dhe më sfiduese. Programet e infrastrukturës kanë caktuar si prioritet të lartë pjesëmarrjen qytetare, duke kërkuar kontributin e qytetarit në përcaktimin e projekteve prioritare, përfshirjen e qytetarëve në vendim-marrje nga ana e qeverive komunale, dhe mbikëqyrjen qytetare të shpenzimeve dhe të fondeve të infrastrukturës. USAID-i ka mbështetur formimin e qindra grupeve të komunitetit që i kanë angazhuar aktivisht zyrtarët komunalë në zgjidhjen e problemeve të ngutshme sociale, shëndetësore dhe ekonomike. Përpjekjet e tilla kanë shërbyer si modele të shkëlqyeshme të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe të bashkëpunimit me qeveritë lokale, dhe po ashtu kanë demonstruar që qytetarët dhe zyrtarët publikë mund të punojnë me sukses në zonat multietnike. Duke u sëndërtuar mbi këto modele të hershme, programet pasuese të USAID-it kanë mbështetur iniciativat civile nga grupet joformale të qytetarëve për të

avokuar me sukses për ndryshime të politikave në nivelin lokal dhe të veprimeve nga zyrtarët komunalë.

Ngjashëm, programi i avokimit për OJQ-të i USAID-it ka kontribuar në avokimin e suksesshëm nga OJQ-të si në nivelin lokal, ashtu edhe atë qendror. Për shembull, si rezultat i avokimit të OJQ-ve, disa qeveri komunale kanë miratuar rregullore të reja, kanë ftuar grupe të posaçme të interesuara që të bëjnë rekomandime mbi buxhetet komunale, dhe kanë shfrytëzuar qasjet bashkëpunuese me qytetarët dhe OJQ-të në caktimin e prioriteteve të politikave. Grupet e ekspertëve të OJQ-ve janë duke kontribuar në debatet politike kyçe, duke u siguruar donatorëve dhe Kuvendit dokumente politike mbi reformën zgjedhore, duke lobuar për ligje të reja, dhe duke tërhequr vëmendjen e mediave ndaj iniciativave të rëndësishme ligjvënëse, siç është projekligji mbi lirinë e informimit. OJQ-të kanë shërbyer si vëzhgues vendorë të zgjedhjeve, avokatë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (p.sh. atyre njerëzore, të konsumatorit, të ambientit, të femrave), ndërkaq janë duke filluar të luajnë rolin e kujdestarit, për shembull duke monitoruar tenderat publikë në nivelin lokal. Dy koalicione – Rrjeti i Grave Kosovare dhe rrjeti “Femisphera”, e kanë edukuar me sukses publikun mbi çështjet e dhunës në vend dhe pjesëmarrjen e pabarabartë të femrave në ekonomi.

Pas dëmit shkatërrues gjatë konfliktit, USAID-i ka ndihmuar në rindërtimin e kullave të transmetuesve dhe elementeve të tjera të rëndësishme të infrastrukturës së mediave, duke pasur si rrjedhojë vendosjen e shpejtë të burimeve të lajmeve dhe informatave të besueshme. USAID-i ka kontribuar në themelimin e shoqatave profesionale të mediave, krijimin e një agjencie profesionale të lajmeve dhe në suksesin e shtypshkronjave private, dy stacioneve televizive të pavarura private në mbarë-Kosovën dhe një morie stacionesh radio dhe televizive lokale. Gazetarët, redaktorët dhe menaxherët nga gazetatat dhe stacionet radio dhe televizive kanë përfituar nga trajnimi në bazat e gazetarisë, raportimin hulumtues, reklamim, menaxhim të biznesit dhe etikës. Megjithë problemet që e kërcënojnë qëndrueshmërinë dhe rritjen e sektorit të mediave, Kosova sot gëzon pluralizëm të burimeve të informacionit dhe nivel të lartë të lirisë së shtypit.

E. QASJET NË PROGRAM

Në pesë vitet e ardhshme, programet nën OS 2.1 do të sëndërtohen mbi punën e mëparshme me shoqërinë civile dhe mediat, për të zhvilluar një bashkëpunim efikas ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverisë. Iniciativa e re do të përmirësojë efikasitetin e qeverive lokale, për të vepruar si ofrues më të mirë të shërbimeve. Ndihma do të përqëndrohet në krijimin e partneriteteve në nivelin lokal, duke u dhënë të gjithë bartësve kryesorë lokalë mundësi të bashkohen, t'i identifikojnë dhe t'i zgjidhin çështjet me prioritet.

1. Aktivitetet ilustruese

Shoqëria civile dhe mediat: USAID-i do të vazhdojë t'i aftësojë organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e qytetarëve që të jenë avokatë efikas, të promovojë zhvillimin e ekspertizës vendore në krijimin e politikave dhe do të fuqizojë aftësinë e shoqërisë civile dhe mediave që të kryejnë rolin e kujdestarit. Përpjekjet do të vazhdojnë për ndërtimin e profesionalizmit të mediave të pavarura, të sigurojnë qëndrueshmërinë e tyre financiare dhe të mbrojnë pavarësinë e tyre redaktuese. Këto aktivitete po ashtu do të promovojnë qarkullimin e lirë të informacionit në shoqëri duke mbështetur përpjekjet për t'i

informuar qytetarët mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisje.

Qeverisja lokale: USAID-i do t'i integrojë aktivitetet e tij të shoqërisë civile dhe të mediave me programin e ri të qeverisjes lokale që do t'i përzgjedhë disa komuna për projektet eksperimentale, dhe pastaj do t'i aplikojë mësimet e nxjerra në tërë Kosovën. Programi i ri do të trajtojë çështje të gjëra të politikave përkitazi me kompetencat komunale dhe decentralizimin, si dhe ofrimin e ndihmës praktike në nivelin lokal. Në aktivitetet në nivelin lokal, ka gjasë të përfshihet trajnimi në punë dhe ndihma për të përmirësuar menaxhmentin dhe udhëheqjen komunale, të rrisë transparencën dhe përgjegjshmërinë e qeverisë komunale, dhe t'u ndihmojë zyrtarëve komunalë në nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal. Po ashtu ndihma mund ta trajtojë planifikimin urban, menaxhmentin financiar, kontaktimin publik dhe prioritetet tjera. Këto aktivitete do të plotësohen me aktivitetet e shoqërisë civile dhe të mediave që do të sigurojnë pjesëmarrje publike, ndërkaq mbikëqyrje nga OJQ-të dhe mediat.

2. Lidhjet

Faktorët e tërthortë: Aktivitetet që e mbështesin këtë objektiv do t'i trajtojnë të katër faktorët e tërthortë. Qëllimi kryesor i shumë aktiviteteve është të rritet transparenca dhe përgjegjshmëria, dhe si rrjedhojë të zvogëlohen mundësitë për korrupsion. Aktivitetet e qeverisjes lokale, do të ndihmojnë sidomos në nxitjen e një ambienti që do të jetë i favorshëm për kthim dhe riintegrim, ndërkaq të zbusë rrënjët e shkaqeve të konfliktit. Aktivitetet e shoqërisë civile do të vazhdojnë të mbështesin iniciativat për rininë dhe gjinitë dhe do t'i ndihmojë OJQ-të që avokojnë në emër të të rinjëve dhe të femrave.

Objektivat e tërësishëm strategjikë: Aktivitetet nën këtë objektiv do të lidhen më së ngushti me OS 2.2. Avokimi i OJQ-ve dhe qarkullimi i lirë i informatave janë qenësore për reformat e nivelit qendror në degët gjyqësore, ekzekutive dhe ligjvënëse, dhe do të bashkërendohen ngushtë me aktivitetet e zgjedhjeve. Aktivitetet e qeverisjes lokale për të promovuar zhvillimin ekonomik lokal, po ashtu do të lidhen ngushtë me aktivitetet nën OS 1.3. Në ngritjen në një shkallë më të lartë të transparencës së qeverisë lokale, ky objektiv do të funksionojë me decentralizimin fiskal dhe do ta plotësojë atë nën OS 1.2, i cili është duke i instaluar sistemet transparente të tatimeve dhe të buxhetit në nivelin lokal.

F. QËNDRUESHMËRIA

USAID-i pret që në fund të periudhës së strategjisë, pjesëmarrja e qytetarëve në të gjitha nivelet e qeverisjes në Kosovë do të rritet, si në aspektin e numrit të qytetarëve dhe grupeve politikisht aktive, ashtu edhe në aspektin e fushëveprimit të angazhimit dhe ndikimit të tyre. Qëndrueshmëria do të trajtohet duke zhvilluar aftësinë e OJQ-ve për të trokitur në burimet tjera të financimit, të ndryshme nga donatorët ndërkombëtarë. Qytetarët do të jenë të aftë dhe të etshëm të marrin pjesë në forumet dhe mbledhjet publike, duke kërkuar dhe siguruar që qeveria mbështet të drejtat e tyre. Grupet e OJQ-ve do të jenë në gjendje të tërheqin vëmendjen e mediave ndaj çështjeve kyçe dhe të sigurojnë mbikëqyrje në krijimin e politikave në nivelin lokal dhe në zbatimin e këtyre politikave. Më saktë ndihmës ndaj mediave do t'i vijë fundi. Nëse ekziston rritja e qëndrueshme ekonomike, mediat pluraliste, private dhe publike duhet të jenë të afta ta mbajnë veten me kalimin e kohës dhe ta ruajnë profesionalizmin dhe pluralizmin.


Përparim i madh do të arrihet në krijimin e një qeverie më efikase, transparente dhe të përgjegjshme që ka funksione dhe përgjegjësi të qarta kundruall qeverisë në nivelin qendror dhe qytetarëve, dhe aftësi për t'i përmbushur ato. Një kornizë e re ligjore dhe e rregullativës që pasqyron ndërrimet e nevojshme strukturore, do të zbatohet me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare në tërësinë e saj. Ofrimi i shërbimeve bazë do të përmirësohet dhe do të sigurohet përmes mekanizmave të ndryshëm.

USAID/ DEMOKRACIA DHE QEVERISJA E KOSOVËS OS 2.1

USAID/Qëllimi i Programit të Demokracisë së Kosovës: Zyrtarë më të aftë dhe më përgjegjës të qeverisë që veprojnë në përputhje me sundimin e ligjit, që përfaqësojnë interesat e qytetarëve dhe që sigurojnë shërbime transparente, të përgjegjshme, të drejta dhe efikase me kontribut nga qytetarët, komunitetet, shoqëria civile dhe mediat

OS 2.1: Shoqëria civile dhe qeveria janë partnerë më efektivë në arritjen e qeverisjes së mirë.

Treguesit:
Qytetarët dhe qeveritë komunale bashkëpunojnë në përcaktimin e prioritetëve të buxhetit.
Iniciativat publike-private ekzistojnë.
Afati kohor: 2003-2010



OBJEKTIVI STRATEGJIK 2.2: QEVERI MË E HAPUR DHE MË PËRGJEGJËSE QË VEPRON NË PËRPUTHJE ME SUNDIMIN E LIGJIT**A. DEKLARATA E OBJEKTIVIT STRATEGJIK**

Ky OS do të mbështesë transformimin e Kosovës në vetëqeverisje me anë të fuqizimit të institucioneve demokratike të krijuara kohëve të fundit dhe duke u ndihmuar kosovarëve të marrin në zotërim të plotë këto organe. Qasja e demokratizimit e USAID-it deri tani ka qenë e përqëndruar në promovimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë gjatë fazës kalimtare të administrimit ndërkombëtar. Kjo qasje do të zgjerohet për të përfshirë krijimin e një sistemi të zgjedhjeve vërtet përfaqësues, partitë politike përgjegjëse, një organ ligjvënës që ushtron mbikëqyrje efikase, një gjyqësor të pavarur të plotësuar me personel profesional, kompetent në aspektin ligjor, administratë efikase të gjykatave dhe qasje të shtuar në drejtësi për të gjithë kosovarët. Fuqizimi i këtyre institucioneve kryesore do ta ndihmojë Misionin që ta arrijë qëllimin e tij të ndihmojë që Kosova të bëhet demokratike dhe e vetëqeverisur, duke ofruar mundësi dhe të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët.

B. ANALIZA E PROBLEMIT

Njëri nga synimet kryesore të Rezolutës 1244 të KSKB-ve është themelimi i institucioneve demokratike të vetëqeverisjes. Përpjekjet deri tani janë përqëndruar thjeshtë në themelimin e këtyre institucioneve që po lindin; vetëqeverisja e vërtetë akoma nuk është arritur. Që Kosova të bëhet demokratike dhe ekonomikisht e qëndrueshme, qeveria duhet të jetë e hapur dhe t'u përgjigjet njerëzve të saj dhe që të funksionojë në përputhje me sundimin e ligjit. Ky është një ndryshim rrënjësor për Kosovën, që kërkon shumë reforma. Në reforma të konsiderueshme hyjnë sistemi i ri i zgjedhjeve që u mundëson kosovarëve të kërkojnë përgjegjësi drejtpërdrejt nga politikanët, një kornizë e gjërë ligjore që siguron kontrolle dhe baraspesha, dhe një sistem gjyqësor të paanshëm dhe transparent që mbështet sundimin e ligjit.

Duke filluar në vitin 1989, në Kosovë nga regjimi i Milosheviqit është imponuar me dhuinë një sistem i apartheidit. Shqiptarët etnikë janë përzënë nga puna, janë dëbuar nga shkollat e mesme dhe të larta, dhe pothuajse të gjitha shërbimet qeveritare janë mbajtur duke u bazuar thjeshtë në përkatësinë e tyre etnike. Shqiptarët ngritën struktura paralele për shumicën e shërbimeve bazë dhe iu drejtuan OJQ-ve për t'i përmbushur nevojat e tyre themelore. Katër vjet pas përfundimit të apartheidit, kujdesi publik i qeverisë dhe i politikanëve vazhdon me ngulm, ndërkaq ka pak pranim të konceptit të punës në kuadër të sistemit dhe duke e respektuar atë. Krahas pjesëve të tjera të ish-Jugosllavisë, përvoja, tradita dhe kultura e vetëqeverisjes demokratike, si në mesin e qytetarëve, ashtu edhe të zyrtarëve nuk kuptohet mirë.

Nën presionin e bashkësisë ndërkombëtare për t'i mbajtur zgjedhjet shpejt, UNMIK-u ka miratuar një sistem të zgjedhjeve që nuk kërkon zona zgjedhore, duke shmangur në këtë mënyrë regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë që është i kushtueshëm dhe që merr kohë. Kosovarët tani po punojnë sipas këtij sistemi të zgjedhjeve me lista të mbyllura që përforcon shkëputjen në mes të qytetarit dhe qeverisë, dhe koncentron pushtetin në pjesën më të lartë të partive politike. Si rezultat, udhëheqësit e rinj të partisë mund të kandidohen për post vetëm nëse ata e sigurojnë vendin në listat e mbyllura, proces që kontrollohet nga elita e partisë, ndërkaq qytetarëve u mohohet mundësia të kërkojnë përgjegjësi nga politikanët e veçantë, për arsye se ata nuk mund të votojnë për kandidatët

e veçantë. Po ashtu ky sistem i ka “homogjenizuar” partitë e mëdha, duke e përforcuar tendencën e tyre të fushatës për të theksuar vetëm çështjen e statusit të Kosovës, ndërkaq duke lënë pas dore çështjet që i preokupojnë drejtpërdrejt votuesit.

Apartheidi jo vetëm që i ka ndarë qytetarët nga politika, ai po ashtu u ka mohuar udhëheqësve shqiptarë të Kosovës një dekadë të përvojës qeverisëse. Kosovarët asnjëherë nuk i kanë drejtuar zgjedhjet e veta, dhe ekziston pak përvojë në të gjitha elementet e shtetit. Ky problem ndërlikohet mëtej nga mungesa e qartësisë së përgjegjësive të IPVQ-ve kundrejt atyre të UNMIK-ut, kalimi i ngadalshëm i pushtetit te strukturat e IPVQ-ve, dhe pasiguria në lidhje me statusin përfundimtar të Kosovës, të gjitha këto bëjnë pak për të ndërtuar besimin e qytetarëve në institucionet e tyre demokratike.

Sipas kornizës së tanishme, kosovarëve u mungon funksioni kyç i vetëqeverisjes demokratike – ai i kontrolleve dhe baraspeshës midis degëve të qeverisjes. Për shembull, Kuvendi nuk mund ta ushtrojë me efikasitet mbikëqyrjen e degës ekzekutive, për arsye se atij i mungon pushteti për t’i detyruar ministrat ose nëpunësit e shërbimit civil të dëshmojnë para komisioneve të tyre, dhe kanë shumë pak mundësi vendosje buxhetore për ta shfrytëzuar si forcë shtytëse, meqë buxheti është nën kontrollin e UNMIK-ut. Ekspertët ligjorë ndërkombëtarë që përfaqësojnë pjesën e UNMIK-ut të degës së dyfishtë ekzekutive dominojnë në gjyqësinë që po krijohet, ndërkaq ka shumë pak legjislacion të qeverisjes së mirë.

Në fund të konfliktit në vitin 1999, sistemi i drejtësisë ishte i pajisur keq për të vepruar me efektshmëri, dhe kjo nuk mund t’i trajtonte tensionet e vazhdueshme ndëretnike, qerimet e hesapeve dhe shpërndorimet e të drejtave të njeriut. Qytetarët u janë frikësuar sulmeve ndëshkimore nëse ata sjellnin dëshmitarë në polici, ose nëse dëshmonin në gjykatë, e po ashtu ata kanë pasur mungesë të përgjithshme të besimit në sistemin e drejtësisë në kuptimin se të drejtat e tyre nuk do të mbroheshin. Gjykatësit dhe prokurorët serbë të Kosovës kanë ikur, ndërkaq juristët profesionistë shqiptarë të Kosovës, të cilët janë kthyer në sistemin e rimëkëmbur të gjyqësisë, jo vetëm që u mungon një dekadë e përvojës, ata po ashtu kanë shfaqur trashëgimi të sistemit socialist, të definuar nga një gjyqësor që është kontrolluar nga partia dhe dega ekzekutive. Megjithëse është bërë njëfarë përparimi që nga mbarimi i konfliktit, shumica e këtyre çështjeve mbeten për t’u trajtuar.

C. KORNIZA E REZULTATEVE

Pa marrë parasysh statusin e saj përfundimtar, zhvillimi ekonomik i Kosovës dhe integrimi i saj i mundshëm në strukturat evropiane varet nga aftësia e saj për të krijuar institucione dhe praktika demokratike tani. Trashëgimia e sistemit komunist, një dekadë e apartheidit dhe gjurmët e konfliktit etnik e kanë lënë Kosovën shumë prapa çdo pjese tjetër të Evropës Qendrore dhe Lindore në fillimin e trajtimit të së ardhmës së vet post-komuniste. Përpjekjet për të ndihmuar dhe fuqizuar institucionet e krijuara të IPVQ-ve (përfshirë këtu Kuvendin, Qeverinë dhe gjykatat) do t’i ndihmojnë Kosovës që t’i përmbush standardet e vendosura nga UNMIK-u për ta matur përparimin drejt standardeve për statusin përfundimtar. Ndihma po ashtu do të kontribuojë për forcimin e themeleve të institucioneve demokratike dhe të sundimit të ligjit, përderisa duke siguruar zotërim adekuat kosovar të procesit të krijimit të ligjeve të veta dhe të institucioneve qeverisëse, duke i kontribuar kështu kalimit më të lehtë të pushtetit nga UNMIK-u. Një sistem më përfaqësues i zgjedhjeve, i hartuar dhe i pranuar nga kosovarët, një kornizë

ligjore që mbështet dhe mbron institucionet demokratike, parimet dhe praktikrat, ndërkaq përmirësimet në administrimin e drejtësisë janë gurthemel për zhvillimin e qëndrueshëm demokratik të Kosovës.

1. Lidhjet shkakore

RN 2.2.1: Zgjedhje më përfaqësuese të administruara nga kosovarët

Ky RN do t'i përgjigjet nevojës së ngutshme për të kërkuar që politikanët dhe partitë politike t'u japin përgjegjësi më drejtpërdrejt qytetarëve, dhe për t'i aftësuar kosovarët që të administrojnë zgjedhje të lira dhe të drejta pa mbështetje nga organizatat ndërkombëtare. Një kornizë e re e zgjedhjeve në fund nevojitet të miratohet nga Kuvendi, organet qeveritare dhe organizatat civile do të kenë nevojë të marrin përsipër përgjegjësinë e plotë për administrimin dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve, ndërkaq partitë politike do të ketë nevojë t'u përgjigjen më shumë interesave të qytetarëve.

RN 2.2.2: Korniza ligjore siguron kontrolle dhe baraspesha

Roli udhëheqës i luajtur nga UNMIK-u dhe bashkësia ndërkombëtare në hartimin e kornizës kushtetuese dhe themelimin e IPVQ-ve nënkuptonte që kosovarët kanë pasur zotërim të kufizuar të procesit, dhe se ka pasur pak nevojë për të përcaktuar dhe sqaruar marrëdhëniet midis institucioneve të ndryshme dhe degëve të qeverisë. Pasiqë UNMIK-u vazhdon me bartjen e kompetencave të kosovarët, do të jetë qenësore të ekzistojë një kornizë ligjore e shëndoshë që siguron kontrolle dhe baraspesha, pavarësi të gjyqësorit, ligje dhe rregullore të gjithanshme dhe konsekuente me miratimin e kosovarëve.

RN 2.2.3: Administrim të drejtë dhe transparent të drejtësisë

Ky RN do t'u ndihmojë gjykatësve, juristëve dhe prokurorëve në marrjen e shkathtësive për kryerjen e përgjegjësisë të tyre. Reformat në sistemin e drejtësisë do të vihen në jetë dhe administrimi i gjykatave do të përmirësohet. Në fund, ky RN do të sigurojë që qytetarët të kenë qasje në informacionin që atyre u nevojitet për ta kuptuar sistemin e ri të drejtësisë dhe për të krijuar besimin në të.

2. Supozimet e rëndësishme

- Nuk do të ketë kthim prapa të bartjes së administrimit të zgjedhjeve nga OSBE-ja të kosovarët.
- Pagat e sektorit publik do të mbesin në një normë të jetesës me dinjitet, duke siguruar që juristët profesionistë të mund të denjojnë të qëndrojnë në shërbimin civil mjaft gjatë për t'i zhvilluar aftësitë e veta dhe për të përmirësuar efikasitetin e sistemit të drejtësisë.

D. PËRPARIMI DERI TANI

Që nga fundi i konfliktit në vitin 1999, USAID-i dhe shumë donatorë të tjerë ndërkombëtarë kanë siguruar trajnime të gjëra dhe ndihmë teknike për partitë më të mëdha politike, duke punuar pikësepër me udhëheqjen e tyre për të ngritur strukturat themelore për këto organizata që po krijohen. Asistenca e USAID-it ka ndihmuar në përmirësimin e aftësive të partive për të zhvilluar fushata koherente dhe për t'i përmirësuar praktikrat e brendshme demokratike. Kontributi tjetër i rëndësishëm i USAID-it ishte për të ndihmuar në krijimin regjistrin të parë të votuesve që ka pasur ndonjëherë Kosova, dhe të administratës së zgjedhjeve përmes Ekipit të Përbashkët për

Regjistrim (EPR). Proceset që shkuan lehtë dhe me efikasitet, të ngritura nga EPR-ja kanë mundësuar që tri zgjedhjet e para të Kosovës të vlerësohen si të lira dhe të drejta nga vëzhguesit vendorë dhe ndërkombëtarë.

Me ndihmën e USAID-it, OJQ-të kanë filluar të promovojnë qeverisjen e mirë me anë të avokimit për legjislacion siç janë Liria e Informimit dhe Ligjet mbi Publikimin e Debateve. Kuvendi, i themeluar pas zgjedhjeve të vitit 2001, ka miratuar rregullat e punës, ka krijuar komisione që debatojnë mbi projekt legjislacionin, ndërkaq tejkalon tensionet etnike dhe mosmarrëveshjet me UNMIK-un, për të miratuar legjislacionin dhe për të përfaqësuar interesat e qytetarëve.

Oda e Avokatëve ka dalur si organizatë kumbuese dhe avokon për reformë ligjore, ndërkaq Shoqata e Gjyqtarëve është formuar për të përfaqësuar interesat e anëtarëve të saj. USAID-i i ka mbështetur programet për t'u siguruar juristëve profesionistë dhe qytetarëve qasje në bazat ligjore të të dhënave dhe për t'i trajnuar të gjithë gjykatësit dhe prokurorët ekzistues për të arritur nivelin minimal të pranueshëm të kompetencës në shkathhtësitë praktike që lidhen me punët e tyre. Administrimi i gjykatave është përmirësuar përmes trajnimeve dhe zhvillimit të sistemeve të menaxhmentit dhe atyre automatike, siç është softueri për grumbullimin e tarifave dhe gjobave.

E. QASJET NË PROGRAM

Ndihma teknike dhe trajnimi do t'i fuqizojnë institucionet më të rëndësishme demokratike të qeverisjes të Kosovës: partitë politike, kuvendin qendror dhe sistemin e drejtësisë. Po ashtu me këtë ndihmë do të përmirësohet korniza ligjore që përcakton dhe rregullon proceset demokratike përmes krijimit të legjislacionit për qeverisje të mirë, sistemit të ri të zgjedhjeve dhe përmirësimit të administrimit të drejtësisë.

1. Aktivitete ilustruese

Procesi politik: USAID-i do të sigurojë ndihmë teknike për të ndihmuar krijimin e zgjedhjes së drejtpërdrejtë të politikanëve dhe do t'i inkurajojë partitë politike për t'i përfaqësuar më mirë interesat e qytetarëve. Në këtë do të përfshihet sigurimi i reagimit publik mbi sistemet tjera të zgjedhjeve, dhe mbështetja e dekretimit të një kornize ligjore të përmirësuar. Ndihma teknike dhe trajnimi intensiv po ashtu do t'i përgatitin administratorët kosovarë të zgjedhjeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe në komisionet komunale të zgjedhjeve (KKZ-të) që në fund t'i administrojnë vet zgjedhjet e veta.

Korniza ligjore: USAID-i do t'i mbështesë përpjekjet për të përmirësuar efektshmërinë e institucioneve të IPVQ-ve, përdërisa të sigurojë kontrollat dhe baraspeshën e duhur. Dy fushat kyçe përfshijnë futjen në përdorim të të drejtës së interpelancës për komisionet e Kuvendit, kështu që ministrat dhe nëpunësit tjerë të lartë civilë të mos mund të refuzojnë të dëshmojnë, ndërkaq Kuvendit i jepet "pushteti i kuletës" – vendosja e lirë buxhetore që i siguron degës ligjvënëse shkallë më të lartë të ndikimit mbi degën ekzekutive. USAID-i do të vazhdojë ndihmën për Kuvendin që të përmirësojë aftësinë e vet për të hartuar legjislacion dhe debatuar për të, dhe, në bashkëpunim me OJQ-të dhe Zyrën e Kryeministrit, do të mbështesë hartimin dhe dekretimin e legjislacionit për qeverisje të mirë, duke u ndihmuar IPVQ-ve për përmbushjen e pikave të standardeve të UNMIK-ut.

Administrimi i drejtësisë: USAID-i do të ndihmojë në bartjen e menaxhmentit të gjyqësorit prej UNMIK-ut te Ministria e Drejtësisë, dhe ristrukturimin e funksioneve të menaxhmentit, ashtu që ato të bien nën kontrollin e një organi të menaxhuar vetëm prej gjykatësve dhe funksionarëve në vartësi të tyre. USAID-i do të bashkëpunojë me Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut për finalizimin dhe zbatimin e një strategjie të gjithanshme të reformave në drejtësi gjatë disa viteve të ardhshme. Në përmirësimet në sistemin e drejtësisë do të përfshihen trajnimet për të rritur aftësinë e juristëve profesionistë, ngritjen në një shkallë më të lartë të administratës së gjykatave dhe qasje më të mirë të qytetarëve në drejtësi. Programet e gjëra të trajnimit do të përmirësojnë profesionalizmin dhe etikën e gjykatësve, prokurorëve dhe avokatëve mbrojtës dhe të administratorëve të gjykatave. Administrimi më efektiv dhe më efikas i gjykatave do të bëhet përmes ndihmës së gjërë teknike në terren për secilën nga 55 gjykatat në nivelin komunal dhe atë të qarkut. Në rritjen e qasjes së qytetarëve në drejtësi do të përfshihen përpjekjet për informim publik për të promovuar mirëkuptimin publik për atë se si funksionon sistemi i drejtësisë, si dhe për të drejtat dhe përgjegjësitë e veta.

2. Lidhjet

Faktorët e tërthortë: Aktivitetet që mbështesin këtë objektiv do ta trajtojnë më drejtpërdrejt faktorin e tërthortë të korrupsionit. Zgjedhjet më transparente dhe më përfaqësuese, mekanizmat më të mirë të mbikëqyrjes në kuadër të qeverisë dhe midis degëve të saj, miratimi dhe zbatimi i legjislacionit për qeverisje të mirë dhe përmirësimi i qasjes në drejtësi, të gjitha këto do të kontribuojnë në zvogëlimin e korrupsionit. Aktivitetet nën këtë objektiv, do të kontribuojnë edhe për trajtimin e tre faktorëve të tjerë të tërthortë. Për shembull, rinia dhe femrat do të vëhen në shënjestër të aktiviteteve të procesit politik që sigurojnë trajnime për partitë politike dhe udhëheqësit lokalë. Aktivitetet nën këtë objektiv do të kontribuojnë për lehtësimin e konfliktit duke siguruar qasje të barabartë në drejtësi, veprim në përputhje me sundimin e ligjit dhe përfaqësim të interesave të minoriteteve në institucionet demokratike.

Objektivat e tërësishëm strategjikë: Aktivitetet nën këtë objektiv do të lidhen më ngushtë me OS 2.1. Suksesi i OS 2.2 do të varet pjesërisht nga efektshmëria e mediave dhe e shoqërisë civile për të ndikuar në politikat publike dhe në kërkimin e përgjegjësisë nga Kuvendi dhe Qeveria. Në këtë kohë, një sistem i përmirësuar i drejtësisë dhe korniza ligjore do të përmirësonin kapacitetin e shoqërisë civile, mediave dhe të zyrtarëve lokalë për arritjen e përmirësimeve në nivelin lokal. Në fund, aktivitetet për ta fuqizuar sistemin e drejtësisë, do t'u kontribuojnë OS-ve 1.2 dhe 1.3 duke fuqizuar sundimin e ligjit, një parakusht qenësor për investime dhe rritje ekonomike të qëndrueshme.


F. QËNDRUESHMËRIA

USAID-i pret reforma të rëndësishme në proceset politike kosovare deri në vitin 2005. Një koalicion i organizatave tashmë është duke i ndjekur ndryshimet në sistemin e zgjedhjeve, duke përfshirë një studim fillestar të legjislacionit që do ta ndryshonte përfaqësimin në kuvend prej listave të mbyllura, në sistemin e bazuar në zgjedhës, si dhe avokim për kosovarizimin e plotë të administratës së zgjedhjeve. Partitë politike do të detyrohen t'i përshtaten realitetit të ri të një pushteti më të decentralizuar në bazë, me anëtarë të veçantë të kuvendit, të aftë për të ushtruar më shumë pavarësi nga udhëheqja e partisë. Mbështetja e përqëndruar aty jo vetëm që do të forcojë përpjekjen për reformë zgjedhore, por ajo po ashtu do t'u ndihmojë partive politike që të adaptohen në realitetet e reja; domethënë, për udhëheqësinë e partisë do të jetë shumë më vështirë të kontrollojë jo

vetëm anëtarët e veçantë të kuvendit, por edhe funksionarët e partisë. Partitë politike do të kenë nevojë të bëjnë kompromis me hierarkinë dhe dosjet e veta, dhe të bëjnë punë më të mirë duke shkuar te zgjedhësit e tyre, duke i përfaqësuar më mirë interesat e qytetarëve.

Qëndrueshmëria e kornizës ligjore dhe e reformave gjyqësore është më e vështirë të parashikohet. Rirregullimi i kornizës së tanishme ligjore varet jo vetëm nga vullneti politik i vendit, por ai po ashtu kërkon bashkëpunimin e PPSP-së dhe të UNMIK-ut – dhe mbetet e paqartë se sa entuziastë do të jenë administratorët ndërkombëtarë në çështjen e rihapjes së çështjeve të vështira kushtetuese që shpesh nxjerrin në shesh çështjet e statusit përfundimtar. Sigurisht se legjislacioni për qeverisje të mirë është në horizont, por miratimi i tij mbetet një çështje e hapur për aq kohë sa administratorët ndërkombëtarë refuzojnë ta aplikojnë atë ndaj strukturave të shtyllave të UNMIK-ut. Brenda periudhës së strategjisë do të futen në përdorim reforma kuptimplote ligjore dhe gjyqësore, por për reformën e plotë të gjyqësorit dhe të institucioneve tjera përcjellëse ka gjasa se do të nevojitet edhe një dekadë tjetër përpjekjesh.

USAID/ DEMOKRACIA DHE QEVERISJA E KOSOVËS OS 2.2



OBJEKTIVAT E POSAÇME

Dy aktivitete të rëndësishme do të zbatohen si objektiva të posaçme. Të dyja janë me rëndësi jetike për zhvillimin e Kosovës, por janë jashtë objektivave kryesore të USAID-it. Përveç kësaj, të dyja janë shumë të kufizuara në fushëveprimtari dhe zbatohen si pjesë e një përpjekje më të madhe të donatorëve.

OPsc 4.11: Kundër-Trafikimi

A. DEKLARATA E OBJEKTIVIT

Ky objektiv i posaçëm do të kontribojë për përpjekjet e vazhdueshme globale për ë parandaluar dhe luftuar trafikimin e femrave dhe të fëmijëve. Ky aktivitet do të sigurojë ndihmë dhe mbrojtje për viktimat e trafikimit, duke i kushtuar vëmendje të posaçme riintegrimin të viktimave kosovare. Kjo do ta shpjerë mëtej të kuptuarit e fenomenit të trafikimit dhe do t'i aftësojë organizatat lokale për të siguruar ndërhyrjet e nevojshme dhe të përshtatshme.

B. ANALIZA E PROBLEMIT

Trafikimi i personave është shkelje e neveritshme e të drejtave njerëzore e cila është në rritje për nga vrazhdësia dhe madhësia. Çdo vit mijëra persona, kryesisht femra trafikohen nga, prej, ose përmes vendeve të Evropës Juglindore dhe mbahen në kushte që arrin deri në skllavëri. Kosova gjithnjë e më shumë është bërë tërheqëse për trafikimin, meqë siç perceptohet ofrohet kombinim i faktorëve të favorshëm: situata e pas konfliktit, institucionet e porsaformuara demokratike, sundim joadekuat i ligjit dhe kufij me të çara. Këta faktorë dhe të tjerët janë hulumtuar në mënyrë të thukët nga trafikantët dhe grupet e organizuara kriminale.

Kosova pikësëpari është vend destinimi dhe tranziti për trafikim. Megjithëse pak dihet për trafikimin e brendshëm ose trafikimin e femrave dhe të fëmijëve jashtë Kosovës, shumë ekspertë kanë drojën se Kosova mund të bëhet vendi kryesor dërgues. Rastet në dy vitet e fundit tregojnë se trafikimi i brendshëm (prostitucioni i detyrueshëm) është problem në rritje në Kosovë, dhe se trafikimi i kosovarëve në rajonet tjera po ashtu ka të ngjarë të rritet. Si shtesë në përpjekjen për ta parandaluar trafikimin në përgjithësi ende duhet të krijohen sistemet dhe mekanizmat për të ndihmuar në identifikimin, përkrahjen, mbrojtjen dhe ndihmën për riatdhesim dhe riintegrim të këtyre individëve të trafikuar. Përderisa ekziston një sistem përcjellës i bashkërenduar dhe plotësisht operativ për viktimat e huaja të trafikimit, një ndihmë e tillë nuk ekziston për viktimat vendore. Inkuadrimi i qeverisë dhe i OJQ-ve vendore në këtë ndihmë është i kufizuar nga aftësia, si dhe mungesa e vetëdijës dhe e informacionit mbi natyrën e vërtetë të trafikimit. Perceptimi i gabuar kulturor dhe social i fenomenit dhe damkosja nga bashkësia që i bëhet çdo viktime, tani për tani e pengojnë aftësinë për të ofruar ndihmë efikase ndaj viktimave vendore, sidomos për periudha më të gjata.

C. QASJA E PROGRAMIT

Masat kundër-trafikimit duhet t'u ndihmojnë si viktimave të mundshme, ashtu edhe atyre të tanishme, dhe si rrjedhojë në to duhet të përfshihen aktivitetet e *parandalimit dhe të*

mbrojtjes. Programi i USAID-it është një komponent i përpjekjes më të gjërë kundër- trafikimit të zbatuar nga Organizata Ndërkombëtare Për Migracion. Në donatorët tjerë për këtë përpjekje përfshihen Qeveritë e Suedisë, Finlandës dhe Italisë, si dhe OJQ-të. Duke i kombinuar përpjekjet tona me donatorët tjerë nën një organizatë zbatuese, do të lëshohet në funksion një përpjekje më e gjithanshme dhe e bashkërenduar, për t'i neutralizuar si shkaqet, ashtu edhe efektet e trafikimit.

Donatorët tjerë janë duke i mbuluar aktivitetet që u ndihmojnë viktimave të huaja të trafikimit të sjellura në Kosovë, duke përfshirë ndihmën për strehim dhe riatdhesim. Po ashtu nga donatorët tjerë financohet edhe një fushatë e madhe rajonale e vetëdijësimit publik. Ndihma e USAID-it/Kosovë do të përqëndrohet në punën me institucionet vendore dhe do të përqëndrohet në:

Trajnimitin e zyrtarëve qeveritarë: Përpjekjet e trajnimit do të përqëndrohen në këta zyrtarë përgjegjës për ndalimin e trafikimit, duke i sensibilizuar para zyrtarëve komunalë si dëmin në njerëz, ashtu edhe atë ekonomik që shkaktohet nga kjo praktikë. Po ashtu do të trajnohen edhe gjykatësit për ta administruar drejtësinë në mënyrë të ndjeshme dhe përkrahëse që si kundërshtpërblim do të ndihmojë të ndreq jetërat e shkallmuara nga praktika e trafikimit.

Riintegrimin e viktimave kosovare: Do të krijohet një sistem i shpejtë përcjellës, ku viktimat kosovare të trafikimit mund të kërkojnë ndihmë. Kjo do të realizohet përmes ngritjes së një sërë grupesh mbështetëse të OJQ-ve vendore. Këshilldhënia mjekësore, psikologjike dhe juridike do të sigurohet krahas trajnimeve të aftësisimit për punë, për të ndihmuar riintegrimin e qëndrueshëm në bashkësi. Si pjesë e kësaj përpjekje, fushatat e vetëdijësimit publik do të drejtohen kah grupet më të ekspozuara ndaj rrezikut, ndërkaq do të zhvillohen fushata të përgjithshme për ta hequr mitin se “kjo nuk mund të ndodhë në këtë shoqëri.”

D. REZULTATET

Pritet se si rezultat i aktivitetit më të gjërë, Kosova do ta ketë një sistem funksional në mbështetje të viktimave, dhe do të bëjë përparim më të madh në çrrënjosjen e trafikimit përmes intervenimit të hershëm dhe ndjekjes penale më efektive. Megjithëse, aktualisht zbatohet si program dyvjeçar, Misioni supozon se çështja e trafikimit do të sigurojë mbështetje të vazhdueshme përmes jetës së kësaj strategjie.

OPsc 4.12: Energjia

A. DEKLARATA E OBJEKTIVIT

Me këtë aktivitet do të mbështetet transformimi i Kosovës drejt vetëqeverisjes dhe ekonomisë së tregut, duke ndihmuar procesin e transformimit të ndërmarrjes publike, Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), në një kompani të komercializuar fitimprurëse.

B. ANALIZA E PROBLEMIT

Si furnizuesi i vetëm i Kosovës me energji dhe meqë është punëdhënës i madh, dështimi i KEK-ut në sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike dhe shterimi i vazhdueshëm i resurseve të tij të pakta buxhetore ka efekt në të gjitha aspektet e jetës. Ai e çrregullon aktivitetin ekonomik duke shtuar shpenzimet për zhvillimin e biznesit, ndikon në mundësinë e fëmijëve për të mësuar dhe krijon shqetësime sociale në mesin e konsumatorëve të vet të pakënaqur. Megjithë tri vite përpjekjesh intensive nga donatorët, ata sipas vlerësimeve kanë shfrytëzuar 611 milion euro nga donatorët ndërkombëtarë dhe Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, për ta bërë KEK-un një biznes funksional, ajo konsiderohet si ndërmarrje në bankrotim, e paaftë për të siguruar mjaft energji për konsumatorët dhe e paaftë për të grumbulluar më shumë se pagesat minimale për energjinë që siguron, duke përfshirë energjinë që vjedhet ose humb.

Meqë rindërtimi ekonomik mbetet njëri nga synimet kryesore të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-ve, transformimi i KEK-ut është me rëndësi shumë të madhe. Kjo kërkon një qasje shumëpalëshe duke përfshirë donatorët kryesorë, UNMIK-un dhe IPVQ-të. Marrëveshjet e kohëve të fundit bëjnë thirrje për futjen e menaxhmentit “rotativ” me pushtet të plotë, të ndërmarrë çfarëdo masash të domosdoshme për t’i mundësuar KEK-ut të prodhojë ose prokurojë energji të mjaftueshme për të furnizuar me energji elektrike gjatë gjithë kohës. Menaxhmenti i tillë do të ngarkohet me ristrukturimin e KEK-ut nga brenda, duke trajtuar nevojat për riparimin e infrastrukturës, trajnimin e personelit teknik dhe menaxhues, dhe zbatimin e sistemit të distribuimit dhe grumbullimit për të siguruar të ardhura për të paguar për operacionet.

C. QASJA E PROGRAMIT

Ndihma e vazhdueshme e USAID-it për sistemin e distribuimit të KEK-ut, ku është instaluar sistemi i kompjuterizuar i faturimit dhe i grumbullimit, do të vazhdohet me objektivin për t’i mbajtur nivelet e pagesave të konsumatorëve në përpjestim me ato të një shërbimi modern elektrik. Pritet që kjo të përfundohet brenda gjashtë deri dymbëdhjetë muajve të periudhës së strategjisë. Në bashkërendim, në frymën e dobësive të veta të tanishme, do të ketë nevojë të hartohet legjislacioni i ri që të mbështesë politikat e pagimit. Mbështetja e politikave dhe ndihma e kufizuar teknike po ashtu do të sigurohen në bashkëpunim me donatorët tjerë dhe Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, për të instaluar një ekip rotativ të menaxhmentit pa kurrëfarë përzierjesh nga jashtë. Kjo përpjekje e kufizuar duhet të përmbyllet në vitin e dytë të strategjisë.

Si shtesë të këtyre më lart, USAID-i ka ndërmend drejtojë një proces të sigurimit të konsenzuesit dhe vendosjes së të gjitha hapave të nevojshëm për të siguruar interesimin e investitorëve privatë në “gjelbërimin”, e pajisjeve të reja nxjerrëse në fushat e linjitet në Kosovë (më të madhatë në Evropë dhe me cilësinë më të lartë). Evropa Juglindore është hapësirë me mungesë të energjisë, e ndërlidhur me linja të përçuesve që mundësojnë tregtimin rajonal të energjisë elektrike, për të cilën gjë është nënshkruar një marrëveshje nga të gjitha vendet dhe Kosova. Kosova i ka resurset dhe lokacionin për t’u bërë furnizuesi më i madh i rajonit. Investimi privat është e vetmja qasje e realizueshme për ta zhvilluar këtë potencial, duke pasur parasysh strukturat aktuale të dhënies së huave në IFN-të. Resurset dhe potencialet e tregut duhet ta joshin kapitalin privat. Po ashtu marrja

e këtij hapi tani parasheh jetën e kufizuar të kapacitetit të tanishëm të nxjerrjes në KEK. Investimi në kapacitetet e reja nxjerrëse po ashtu do të këtë efekt të përgjithshëm stimulues në ekonomi dhe ofron mundësi punësimi për shumë të papunë, duke përfshirë tepricën e punëtorëve që duhet ta lëshojnë KEK-un.

D. REZULTATET

Si rezultat i kësaj ndihme, pritet që KEK-u të sigurojë pandërprerë energji elektrike, për të cilën paguajnë konsumatorët.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4.2: PROGRAMET E TËRTHORTA**A. DEKLARATA E OBJEKTIVIT**

Aktivitetet e financuara nën këtë objektiv janë të tërthorta për nga natyra dhe do të mbështesin realizimin e të gjithë objektivave strategjikë. Ekzistojnë dy komponente kryesore në këtë objektiv; Programet e trajnimit dhe të arsimimit dhe (2) Mbështetja administrative/teknike.

B. PROGRAMET E TRAJNIMIT DHE TË ARSIMIMIT

Për t'i trajtuar mangësitë në kapacitetet njërezore që e pengojnë aftësinë e Kosovës për të zhvilluar ekonomi dhe sisteme demokratike të pjekura, duhet të bëhen përpjekje të mëdha për t'i ngritur në shkallë më të lartë aftësitë teknike, analitike dhe menaxhuese të popullatës. Kjo nevojë është posaçërisht e madhe në mesin e popullatës së madhe të re, shumica e të cilëve kanë qenë të privuar prej arsimimit cilësor të mesëm dhe universitar. Problemet që rrjedhin nga baza joadekuate e arsimit është çështje që përsëritet në tërë strategjinë; prandaj identifikimi dhe angazhimi në ndërhyrjet përgjegjëse është element kyç për suksesin e objektivave kryesorë të Misionit. Misioni do të zbatojë një qasje tri-degëshe për të trajtuar aspektin e zhvillimit njerëzor të aftësimin të kuadrove. Në këtë qasje do të përfshihen: (1) trajnimi për udhëheqje; (2) shkollimi i lartë afatgjatë; dhe (3) trajnimet teknike dhe studimet afatshkurtëra.

1. Trajnimi për udhëheqje

Qëllimi: Të sigurojë një program ekzekutiv për udhëheqje për menaxherët e nivelit të mesëm, të cilët janë identifikuar si udhëheqës që po krijohen në institucionet kosovare.

Qasja e programit: Nevoja për definime të reja të udhëheqjes, njohurive dhe aftësive është mbizotëruese në mbarë shoqërinë kosovare. Kjo është në veçanti e vërtetë në mesin e profesionistëve përgjegjës për udhëheqjen e ministrive, agjencive dhe departamenteve të qeverive të reja qendrore dhe lokale që po lindin. Profesionistëve të tillë u nevojitet të fitojnë përvojë në krijimin dhe udhëheqjen e llojeve të posteve që nga ata tani po kërkohet t'i udhëheqin.

Programi i trajnimit për udhëheqje pason programin aktual të Hope Fellowship, që zbatohet nga Këshilli Kombëtar Shqiptaro - Amerikan, që po siguron praktikë 3 muajshe në SHBA për udhëheqëset femra që po dalin. Programi i ri do të ofrojë një qasje të mësimdhënies-nxënies për aftësimin e kuadrove, duke siguruar trajnime në Kosovë për një periudhë të zgjatur. Pikëpërqëndrimi do të jenë menaxherët e nivelit të mesëm në institucionet ekonomike dhe demokratike që po krijohen. Trajnimi do të përqëndrohet në zbatimin praktik, duke shfrytëzuar teknikat pedagogjike që bazohen në parimet e arsimimit të të rriturve dhe në metodat e pjesëmarrjes. Trajnimi përqëndrohet në projekt, që kërkon nga pjesëmarrësit të zhvillojnë dhe aplikojnë iniciativa udhëheqëse në vendet e tyre të punës. Në program po ashtu përfshihet fuqizimi i rrjetit të të diplomuarve për t'u bërë aktivistë në: (1) udhëheqjen e ndryshimeve në shoqërinë civile përmes avokimit; (2) hartimin e programeve për udhëheqësit e rinj që po krijohen; dhe (3) organizimin e seminarëve publik për të nxitur idetë e reja dhe për ta zgjeruar dialogun dhe modelet e të udhëhequrit të ri në mbarë Kosovën.

2. Fondacioni i arsimimit

Qëllimi: Të rritet kapaciteti për zhvillimin afatgjatë të Kosovës me anë të krijimit të kuadrit të arsimuar mirë, dhe të individëve të trajnuar, të cilët mund që me efikasitet të menaxhojnë dhe udhëheqin, si sektorin publik dhe atë privat në Kosovë.

Qasja e programit: Fondacioni i Arsimimit të Kosovës është duke u zhvilluar si partneritet publik-privat për të siguruar shkollim të lartë në Shtetet e Bashkuara. Kontributi i USAID-it për programin është rezultat i programit të Gjenerimit të Punësimit të Kosovës i zbatuar nën strategjinë e tanishme. Sipas këtij programi janë shtuar shkathtësitë për biznes dhe njohuritë, mundësitë e marketingut janë ngritur në shkallë më të lartë dhe qasja ndaj financimit përmes bankave komerciale është rritur.

Mirëpo, vetëm këto masa nuk janë të mjaftueshme për t'i rregulluar çështjet ekonomike dhe shoqërore me të cilat ballafaqohet Kosova. Çështja e papunësisë do të trajtohej vetëm nëse aftësia e kosovarëve, e sidomos e të rinjëve ngritet në një nivel më të lartë që do t'u mundësonte atyre të zhvillonin subjekte ekonomike të afta për të mbijetuar që mund t'i kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme prodhimit të vendit, dhe të jenë konkures në tregjet rajonale dhe botërore. Çështje të njëjta të aftësive gjenden në sektorin publik, ku administratorët dhe udhëheqësit duhet të kenë aftësi dhe njohuri për të drejtuar dhe menaxhuar kursin ekonomik të Kosovës të orientuar kah rritja. Lloji dhe cilësia e arsimit të lartë që nevojitet për t'i zhvilluar aftësitë menaxhuese, administrative dhe të ndërmarrësisë nuk janë në dispozicion në Kosovë në këtë kohë. Prandaj është domosdoshmëri që një numër i mjaftueshëm i popullatës ta marrë këtë trajnim jashtë vendit.

Ekzistojnë përparësi shtesë në sigurimin e mundësive për arsimim në Shtetet e Bashkuara. Kosova përfaqëson një shoqëri të moderuar muslimane me orientim shumë pro-përëndimor. Shumica e kosovarëve janë shumë përceptues ndaj ideve dhe idealeve amerikane. Përvoja afatgjatë akademike në Shtetet e Bashkuara do të sigurojë ekspozim të mtejshëm ndaj vlerave amerikane, do të farkonte lidhje të qëndrueshme dhe do të krijonte mundësi praktike dhe të paçmueshme të punës në rrjet.

Fondet e USAID-it do të sigurojnë bursa shkollimi për studime diplomike dhe pas diplomike në fushat që do ta mbështesnin rritjen ekonomike dhe investimet në Kosovë, siç janë ekonomia, financat, menaxhmenti, biznesi, drejtësia, administrata publike dhe trajnime në sektorë/industri të caktuara. Partnerët e sektorit privat mund t'i drejtojnë kontributet e tyre në fushat tjera akademike.

3. Trajnimi pjesëmarrës

Qëllimi: Që të sigurohet një mekanizëm përgjegjës dhe fleksibil që do të sigurojë trajnime të pikësnyuara dhe mundësi studimi afatshkurtëra, të cilat i plotësojnë dhe i shtojnë të gjithë objektivat strategjikë. Përveç kësaj, kjo do të lejojë mbështetje për trajnim mbi çështjet e tërthorta të korrupsionit, konfliktit dhe pajtimit, gjinisë dhe rinisë.

Qasja e programit: Ky aktivitet e funksionalizon Ndhmën Teknike Strategjike të Agjencisë për Rezultate përmes kontratës së Trajnimit (START) dhe do të menaxhohet nga Komiteti i Trajnimit i përbërë nga përfaqësuesit nga secili objektiv strategjik. Mbikëqyrja do të sigurohet nga Zyra e Programit. Komiteti i Trajnimit do të jetë përgjegjës për krijimin e një plani vjetor të trajnimit dhe për caktimin e prioriteteve. Ekipi i objektivit strategjik që e financon ngjarjen e trajnimit do të jetë përgjegjës për të siguruar që planet e trajnimit të jenë të plota dhe të gjithanshme, që pjesëmarrësit të përziejdhën në mënyrë të drejtë dhe që monitorimi i vazhdueshëm siguron që trajnimi po funksionalizohet.